

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.128 TETOR 2018



REDAKSIA:

KRYEREDAKTOR

Syrja Xhelaj

REDAKTORË

Nuri Çuni

Kujtim Boriçi

KORRESPONDENTËT

Jakup Gjoca - Greqi

Eugen Shehu - Zvicër

Përparim Kapllani - Kanada

Agim Cani - Gjermani

Enea Muhameti - Itali

KONSULENTË

Arian Leka

Zenel Anxhaku

Blerina Harizaj

Agim Zeka

Besnik Anxhaku

DESIGN

Studiograf "A&N"


**SHTYPET NË
SHTYPSHKRONJËN**

"Urtësia
Bektashiane"

Tetor, 2018



Baba Shefqeti me halle



Baba Shefqeti me halle

Ç'është koncepti pastaj kur u vuan pushtim bektarë, por caktimi i babit bektarë?

Cajli bektarë të dardha, baba Kamberi, si zot, shpesh, e vuri baba Shefqet në krushet e gjatë, prandaj caktimi i babit bektarë u bë një punë e vështirë. Babi Kamberi, si zot, shpesh, e vuri baba Shefqet në krushet e gjatë, prandaj caktimi i babit bektarë u bë një punë e vështirë. Babi Kamberi, si zot, shpesh, e vuri baba Shefqet në krushet e gjatë, prandaj caktimi i babit bektarë u bë një punë e vështirë.

Në baba Kamberi erdhi baba Shefqet Gjoca. Por të gjithë Bektashianët e baba Shefqet Gjocës i quajtën baba Shefqet Gjocën, si zot, shpesh, e vuri baba Shefqet në krushet e gjatë, prandaj caktimi i babit bektarë u bë një punë e vështirë.

Si zot, shpesh, e vuri baba Shefqet në krushet e gjatë, prandaj caktimi i babit bektarë u bë një punë e vështirë. Babi Kamberi, si zot, shpesh, e vuri baba Shefqet në krushet e gjatë, prandaj caktimi i babit bektarë u bë një punë e vështirë.

Si zot, shpesh, e vuri baba Shefqet në krushet e gjatë, prandaj caktimi i babit bektarë u bë një punë e vështirë. Babi Kamberi, si zot, shpesh, e vuri baba Shefqet në krushet e gjatë, prandaj caktimi i babit bektarë u bë një punë e vështirë.

Profeti Muhamed në hadithet e tij thotë: "Kur keni nevojë drejtohuni vendeve të shenjtë". ...

Dita e Ashures: Thirrje për paqe



Abeta DUKU
 A shtrirë përballë nënës së vdekurë, nënë e vdekurë përballë nënës së vdekurë...
 4 | Nr. 1281 | Tetor 2018

Dita e Ashures: Thirrje për paqe

Ashtrë siç pritej, pas ditës së fundit të Matemit, (agjërimi i zisë ose zija përkujtimore në nderim të martirëve të Qerbelasë), e enjttja e 20 shtatorit të këtij viti, kishte mbushur si rrallë ndonjëherë mjediset e Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë, në ritet tradicionale të ditës së Ashures. ...

Vatër drite e përrjetshme



Komiteti i 110 personave i gjatë në qytetin e paqes shqiptarë të Kosovës në tërbim bashkëkohor të Kosovës
 Dita e babait, e përvendimit të vetës...
 4 | Nr. 1281 | Tetor 2018

Vatër drite e përrjetshme

Kë qenë 15 tetori i vitit të largët 1908, Kur çuditërisht në mejdanin e teqesë së Koshtanit, në prani të baba Ahmetit dhe dervishëve të tij, u ulën në vend të myhibëve, dhjetëra nxënës që do të mësonin gjuhën e bukur shqipe. Ishte shkolla e parë shqipe që çelej në gjithë vilajetin e Janinës ndaj dhe nxënësit do të vinin nga e gjithë Shqipëria e jugut.



Tek drita tek qiparisi, Del na pret baba Idrizi!
 Mërzitë Spahaj, ndonjëse kam...
 4 | Nr. 1281 | Tetor 2018

Tek drita tek qiparisi

Më Merqez Spahajn, ndonjëse kam tridhjetë minuta që bisedoj, më duket se e kam njohur prej kohësh. Ruan kujtime të vyera për Bënçën dhe sidomos për këtë vend të shenjtë, ku pas 40 vitesh u ringrit një tyrbe e re, përmes një gjelbërimit që merr jetë nga dashuria njerëzore.

Shqiptarët... një shenjt të tyre e ndajnë me botën

Baba Rexhepi
 Qyteti i shenjtë i Tiranës...
 4 | Nr. 1281 | Tetor 2018

Shqiptarët... një shenjt të tyre e ndajnë me botën

Baba Rexhepin përmes jetës së tij të gjatë, njerëzit e kanë njohur në kohëra të ndryshme, e kanë parë nga anë të ndryshme. Këndvështrimi im është ai i një amerikaneje që ka studiuar me të mbi 20 vjet, në teqenë bektashiane të Michiganit.

Dita e Ashures!



Kujtim BORIÇI

Ashtu siç pritej, pas ditës së fundit të Mëmit, (agjërimi i zisë ose zija përkujtimore në nderim të martirëve të Qerbelasë), e enjtja e 20 shtatorit të këtij viti, kishte mbushur si rrallë ndonjëherë mjediset e Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë, në ritet tradicionale të ditës së Ashures. Kishin ardhur klerikë nga teqetet bektashiane brenda e jashtë Shqipërisë, përfaqësues të lartë të besimeve të tjerë fetarë në Shqipëri, besim-

tarë nga Tirana e treva të tjera të vendit, nga Maqedonia, Kosova e deri nga komunitetet bektashiane në vende të ndryshme europiane, nga SHBA e Kanadaja, qytetarë të thjeshtë dhe përfaqësues të strukturave të larta shtetërore e shoqërore të vendit. Ndërkohë, bukurinë e kësaj feste tradicionale ja shtuan më tej grupe e ansamble popullore nga hapësirat mbarëshqiptare, që me këngët e nefeset bektashiane, jo vetëm i dhanë hapësira më të gjera strukturës së programit të përbashkët, por ishin pjesë e grupeve të ndryshme të besimtarëve të shumtë gjatë gjithë ditës. Ndërsa një

Thirrje për paqe



mjedis tejet komod për evenimentin, i zbukuar me kulturë e shije në funksion të prehjes shpirtërore, respektit për martirët e Qerbelasë e domosdoshmërisë së ecjes në udhën e Haxhi Bektash Veliut, shpresës e besimit tek Krijuesi, e bëri më të paqtë e të përzemërt atmosferën e kësaj dite të shënuar.


Mes të ardhurve në këtë ceremoni, ishte dhe një grup gazetarësh

të huaj. Ndërsa bashkëkombas të shumtë na thanë se kanë ardhur na vendbanimet e tyre për të qenë në ritet e Ditës së Ashures.

“Është viti i dytë që udhëtoj nga Zvicra ku banoj familjarisht prej 40 vitesh për të qenë në Selinë e Shenjtë në Ditën e Ashures. Vij me dëshirë dhe gjallërohem. Bashkëbisedoj me vëllezërit e motrat besimtarë bektashianë, përkujto-

jmë dhe adhurojmë martirët e Qerbelasë e kështu, na shtohet më shumë dashuria për njeri-tjetrin, për të Madhin Zot... Sa të kemë forca e mundësi, çdo vit do të vij në këtë ditë të bekuar...”- pohon për ‘Urtësia’, 73 vjeçari Naim Bakaj, bashkëkombas nga Tetova me banim në Zvicër.

Mes një grupi besimtarësh, në momentin kur ende nuk ka nisur



KRYEGJYSHI BOTËROR:

Këto ditë, jo vetëm këtu në mejdanin e Selisë sonë të Shenjtë Botërore, por nga teqeja në Gjakovë, ajo 'Harabati-Baba' në Tetovë dhe deri në

tegenë e Sarandës, ne baballarë e dervishë kemi pasur një bashkëbisedim të frytshëm me myhibët dhe dashamirësit bektashianë. Ne e shohim se jo gjithçka shkon mirë në këto vite, kur shpresonim aq shumë dhe ëndërronim aq shumë.

Ne me dhimbje konstatojmë se shëmbëlltyra të frikshme të Jezidit të dikurshëm, sillen sot midis nesh, duke dashur të na pengojnë në udhëtimin europian për ku jemi nisur.

Ne shohim se etja për pushtet, për para, për mirëqenie me burim krimi dhe jo burim djerse, e ka kapur për fyti shoqërinë shqiptare, për ti marrë frymën asaj.

Por me shpresë të Zotit, me besimin tonë të pa lëkundur, me shembullin tonë, ne besimtarët shqiptarë do t'i bëhemi barrikadë kësaj shtjelle të verbër të historisë.

Së bashku me kujtimin e vyer të dëshmorëve të Qerbelasë, ne lutemi sot edhe për shpirtrat e politikanëve dhe shtetarëve tanë, për paqen që vjen prej dialogut dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.


Ne u themi atyre nga kjo foltore të ulin gjakrat e t'i shtrinë dorën e bashkëpunimit njeri-tjetrit. Sepse jemi bij të të njëjtit Zot, jemi bij të të njëjtit komb dhe qoftë Zoti, qoftë kombi na urojnë e bekojnë vetëm kur jemi bashkë. Le të punojmë së bashku për të mbjellë shpresën, sepse po largohet nga sytë këmbët brezi i ri, po godasim me duart tona, të ardhmen tonë. Sa nuk është vonë!..."

ceremonia zyrtare, në bisedë e sipër, një i moshuar nga Vlora, M. Halili na thotë: "...Kemi agjëruar nëntë dit të matemit, kemi biseduar e përcjellë vëllazërisht ngjarjet tragjike të Qerbelasë. Kemi kujtuar dhe sjellë ndër mend aktin sublim të 72 dëshmorëve dhe kalorësin e pavdekshëm Imam Hysenin, paqja qoftë mbi 'Të. Kemi parë dhe kemi folur se deri në çfarë mase mund të shkojë djallëzia dhe ligësia njerëzore e trupëzuar tek Jezidi dhe Mavija. Mallkimi i Zotit të Lartë i përcjelltë ata dhe ndjekësit e tyre! E sot, urojmë njeri-tjetrit pa dallime besimi e race, për më shumë dashuri, paqe e mirësi..."

Në sheshin para odeonit, i pari në çeljen e ceremonisë, e mori fjalën Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili ndër të tjera pohoi: "...Të nderuar vëllezër të mijë klerikë dhe besimtarë bektashianë, të ardhur nga Mali i Zi, Kosova, Maqedonia Veriore dhe krejt Shqipëria! Vijmë sot, tek dita e shënuar e Ashures më të vëmendshëm se kurrë ndaj historisë fetare të të parëve tanë. Vëmendja jonë, padyshim ka qenë dhe mbetet tragjedia e Qerbelasë, ndër më kulmoret në historinë e luftërave fetare. Nëpër mejdanet e teqeve tona, në krejt trojet shqiptarë, në këto dit të zisë së matemit, duke shfletuar dhe komentuar ngjarjet e 'Hadikasë', ne, nuk është se kemi ecur vetëm në gjurmët e një tradite shekullore bektashiane. Por akoma më tej, ne kemi përmendur plot respekt jetën e vyer të sa e sa profetëve të Islamit, të cilët me durimin e pakufishëm në përballimin e dhimbjeve njerëzore, mbetën modele të përjetshme, nga të cilat vlen të udhëhiqemi sot e gjithë ditën. Ne përulemi sot me respektin më të thellë ndaj veprës emblematike të Imam Hysenit, paqja qoftë mbi 'Të, sepse në substancë të kësaj veprë është lufta pa kompromis për dinjitet, moral dhe liri njerëzore. Siç është padyshim edhe përpjekja për një Islam të pa yshtur nga politika apo veprimet dinakë dhe të urryer të Jezidit dhe pasuesve të tij. Bektashizmi, tradita dhe fryma e tij, prej 800 viteve dhe deri më sot, kanë rrëfyer se besimin e palëkundur në Zot, të Imam Hysenit, Abaz Aliut dhe 72 dëshmorëve të Qerbelasë, nuk e kanë përdorur asnjëherë si krenari boshe të historisë, përkundrazi, e kanë përdorur si një dritë të pafikur në udhëtimin e tyre. Këto dit, jo vetëm këtu në mejdanin e Selisë sonë të Shenjtë Botërore, por nga teqeja në Gjakovë, ajo 'Harabati-Baba' në Tetovë dhe deri në teqenë e Sarandës, ne baballarë e dervishë kemi pasur një bash-

Ç'është matemi?

Matemi, është agjërimi i zisë, ose zija përkujtimore në nderim të veprës së martirëve të Qerbelasë. Agjërimi i bektashinjve dhe i tarikateve të tjerë alevian, zgjat 10 ditë të muajit hënor të Muharremit.. Gjatë këtyre ditëve besimtarët bektashian, mysliman dhe alevian kudo që ndodhen në botë, për 10 ditë me radhë përkujtojnë në shenjë zie e respekti 72 dëshmorët që ranë në Qerbela, me në krye Imam Hysenin, në shekullin e shtatë, afërsisht 20 tetor të vitit 680, në Irak. Këto ditë bektashinjte e të tjerë mbledhen në teqetë e ndryshme, ku udhërrëfyesit (klerikët) lexojnë "Hadikanë", bëjnë ritualin e përditshëm, duke përkujtuar vuajtjet e profetëve e ngjarjen tragjike të Qerbelasë, për shërbimin e tyre të shenjtë në të mirë të njerëzisë, duke predikuar rrugën e drejtësisë, paqes,



vëllazërisë dhe përsosmërisë njerëzore. Natën e parë u kushtohet vuajtjeve të profetëve: Adem, Nuh, Ibrahim, Jusuf, Musa dhe Krisht, të dytën për Profetin Muhamet, të tretën për Imam Aliun, të katërtën për Imam Hasanin, të pestën për Imam Hysenin (lindja dhe jeta e tij), të gjashtë për Imam Hysenin, ikja e tij nga Medina në Mekë, të shtatën për Myslym Akilin vrasja e tij dhe dy djemve të tij, Myftarin dhe Ibrahimin, të tetën për Imam Hysenin nisja e tij për në Kufë, të nëntën për Imam Hysenin (mbërritja në Qerrbela) dhe natën e dhjetë për martirizimi i tij dhe dëshmorët e tjerë. Për arsye që trimat e kësaj tragjedie shkuan në ahiret, buzëtharë, në këto ditë nuk pihet ujë nga besimtarët si edhe ka shumë kufizime në ushqime të cilat zbatohen rigorozisht.



këbisedim të frytshëm me myhibët dhe dashamirësit bektashianë. Ne e shohim se jo gjithçka shkon mirë në këto vite, kur shpresonim aq shumë dhe ëndër-

ronim aq shumë. Ne me dhimbje konstatojmë se shëmbëlltyra të frikshme të Jezidit të dikurshëm, sillen sot midis nesh, duke dashur të na pengojnë



Ç'është Ashurja?

Ditën e dhjetë të Matemit, për t'i dhënë fund kësaj periudhe agjërimi, zhvillohet një ceremoni e fundit në teqe. Kjo ceremoni fillon në fund të natës së dhjetë. Besimtarët pinë ujin e jetës, sherbetin dhe mbas kësaj vihet ashurja në zjarr dhe vazhdon të nesërmen "Dita e Ashures". Ashurja është ëmbëlsira e posaçme që merr emrin e kësaj dite – Dita e dhjetë do të thotë Ashure. Ashurja të dhjetën ditë të muajit Muharrem shënon përvjetorin e vdekjes së Imam Hysenit në Qerrbela. Ashurja gatuhet me grurë, ujë, niseshte, fasule, bathë, misër, fiq të thatë, rrush të thatë, arra, sheqer (ose mjaltë, pekmez, musht), kanellë. Në ceremoninë fetare recitohet me zë të lartë (nerthije) bëhen lutje fetare në një heshtje

zie. Pastaj bëhen vizita, populli dhe besimtarët shijojnë ashuren, përmendin heroin e Qerbelasë Hysenin. ... Në mesin e ngjarjeve historike "Ashura" dhe "Martirët e Qerbelasë" zënë një vend të veçantë, dhe kjo skenë heroike e përvetshme dhe të gjitha skenat heroike të Ashures, janë model i njerëzve që kërkojnë të vërtetën dhe luftojnë shtypjen ashtu sikurse "Ehli Bejti (a.s)" në përgjithësi është model i jetës dhe i vdekjes, i moralit dhe i xhihadit, i përsosmërisë së njeriut si dhe i mënyrës së jetesës dhe i vdekjes. Për këtë arsye edhe ne lutemi; O Zot jeta dhe vdekja jonë të jetë e ngjashme me jetën dhe vdekjen e Muhamedit (s.a.v.s) dhe familjes së tij.

në udhëtimin europian për ku jemi nisur. Ne shohim se etja për pushtet, për para, për mirëqenie me burim krimi dhe jo burim djerse, e ka kapur për fyti shoqërinë shqiptare, për ti marrë frymën asaj. Por me shpresë të Zotit, me besimin tonë të pa lëkundur, me shembullin tonë, ne besimtarët shqiptarë do t'i bëhemi barrikadë kësaj shtjelle të verbër të historisë. Së bashku me kujtimin e vyer të dëshmorëve të Qerbelasë,

ne lutemi sot edhe për shpirtrat e politikanëve dhe shtetarëve tanë, për paqen që vjen prej dialogut dhe mirëkuptimit të ndërsjelltë. Ne u themi atyre nga kjo foltore të ulin gjakrat e t'i shtrinë dorën e bashkëpunimit njeri-tjetrit. Sepse jemi bij të të njëjtit Zot, jemi bij të të njëjtit komb dhe qoftë Zoti, qoftë kombi na urojnë e bekojnë vetëm kur jemi bashkë. Le të punojmë së bashku për të mbjellë shpresën, sepse po lar-

gohet nga sytë këmbët brezi i ri, po godasim me duart tona, të ardhmen tonë. Sa nuk është vonë!..."

...Pas ceremonisë zyrtare, i erdhi radha programit artistik me këngë, valle e interpretime, përgatitur enkas për këtë ditë. Grupe dhe solistë të njohur të këngës popullore nga të gjithë hapësirat mbarëshqiptare, performuan me profesionalizëm, duke e bërë më të plotë atmosferën festive të Ditës së Ashures.

Ditë mirësie dhe përuljeje



Nga Nuri Çuni

Në udhëtimin e bukur të javës së parë të tetorit, Tdrecht Vlorë shijon një ndjesi të kuptueshme sepse, do vizitonim me rastin e ditës së ashures në teqenë e njohur, nga më të vjetrat të Kuzum Baba, e themeluar në vitin 1600. Historia e saj lidhet me klerikun, shënjtörin, Kuzum Baba, i cili jo vetëm se ishte misionar, por me veprën e tij, u bë i njohur për kulturën fetare që rrezatoi dashurinë pa kufi ndaj Zotit. Kuzum Baba la gjurmë në trevën e Vlorës. Ai u bë legjendë e kohës, e vranë të pabesët në Qafën e Koçiu siç rrëfëhet dhe me kokën e prerë, në duar, ndali udhëtimin në kodrën e mrekullueshme mbi qytet, ku dukej deti pafund Karburuni dhe Sazani, në lindje ndërsa në perëndim të diellit, mrekullohej çdo besimtar e të gjithë vizitorët në teqenë e ngritur me emrin e misionarit. Kjo ishte jo vetëm një mrekulli e natyrës por edhe një mrëekulli e shënjtörin bektashian që

sot vizitohet nga të gjithë banorët e qytetit dhe çdo vizitor i huaj do ndalet në këtë vend të shenjtë.

Ndijesia tjetër e veçantë ishte se do të kremtohej dita e ashures. Historikisht ka 14 shekuj që bëhet kjo ceremoni. Mbas matemit, e cila është agjërimi i zisë, ose zija përkujtimore në nderim të veprës së martirëve të Qerbelasë. Agjërimi zgjati 10 ditë, të muajit hënor të Muharremit, në të gjashtë gjyshatat, në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë dhe në gjithë botën bektashiane. Gjatë këtyre ditëve besimtarët, për 10 ditë me radhë përkujtuan në shenjë zie e respekti 72 dëshmorët që ranë heronjë në Qerbela, me në krye Imam Hysenin, në shekullin e shtatë, afërsisht 20 tetor të vitit 680, në Irak. Në këto ditë gjithë besimtarët nën drejtimin e klerikëve bektashianë lexuan me zë të lartë "Hadikanë", bënë ritualin e përditshëm, duke përkujtuar vuajtjet e profetëve e ngjarjen tragjike të Qerbelasë, për shërbimin e tyre të shenjtë në të mirë



të njerëzisë, duke predikuar rrugën e drejtësisë, paqes, vëllazërisë dhe përsosmërisë njerëzore. Ashurja nuk është një ngjarje por një kulturë e lindur nga islami i pastër, e cila ka luajtur një rol jetik në konsolidimin e tij. Ajo është mbartës i mesazhit të përhershëm në zemrën e historisë. Por Ashurja nuk ka qenë kurrë e izoluar në kufijtë e përcaktuar kohorë apo gjeografikë. Në këtë kontekst spikat qëllimi hyjnor i saj, i lirisë, krenarisë, e shpirtit të veprimit të lirë me natyrën humane dhe pavarësisë kulturore dhe besimit fetar. Në mbrojtje të Islamit, në një hadith thuhet: “Zoti i do punët e mëdha dhe të ndershme dhe është armik i punëve të ulëta dhe të neveritshme.” Kjo ngjarje në fushën e historisë, do të jetë i gjallë edhe emri dhe heroizmi i dëshmorëve të fushës së Qerbelasë.

Në ceremoninë e fundit që u bë në Kuzum Baba erdhi Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, të cilit i uroj mirëseardhjen, dervish Sali Peti. Ky u takua pastaj me klerikët, dervish Mikel Onjea,

baba Faik Selmani dhe gjithë pjesëmarrsit e ardhur nga Vlora, Tirana, Tepelena, Elbasani dhe me urimet e kësaj dite të bekuar. Më pas filloi ceremonia me hymnin kombëtar. Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve përshëndeti midis të tjerave: “se





zemrat njerëzore ende lotojnë. Ende shikojnë me sytë e zemrës gjakun e trimave që derdhën lumë në emër të një shoqërie më të mirë dhe të denjë njerëzore. Zemrat e lotuara për kurbanin e madh të Qerbelasë këndojnë:

Hysejni e deshi njerinë dhe për të u vra, Për të shpëtuar njerëzinë, ra në Qerbela.

Në kujtesë e me respekt do ta afrojmë dhimbjen e madhe të Qerbelasë kurdoherë, duke apeluar në rrezatimin e paqes qiellore, që mbi tokë, të sundojë vullneti i Zotit për drejtësi shoqërore dhe për vëllazëri midis njerëzimit. Detyra

jonë e përbashkët është vendosja e drejtësisë mbi tokë ku të sundojë dashuria dhe paqja. Le të bëjmë të gjithë së bashku realitet vullnetin e të madhit Zot për paqe universale, në shpirtat njerëzor, në mardhëniet midis popujve, pamvarësisht etnive, racave apo ngjyrave. Të gjithë duhet të jemi bij të devotshëm të Krijuesit.” Me këtë rast sipas traditës Kryegjiyshi recitoj me zë të lartë pjesë nga rituali tradicional, e cila u prit nga të gjithë me emocione të veçanta të kësaj ngjarje përkujtimore të Qerbelasë.

Grupi polifonik i Asamblit Çipini gjallëroi me këngë bektashiane dhe mbajti gjallë këtë atmosferë deri në fund të shpërndarjes së Ashures. Kryegjiyshi duke pritur dhe përcjellë besimtarët e dashamirisit me fjalën e ngrohtë dhe dashurinë të i Madhi Zot dha mesazhin e dashurisë dhe vëllazërimit. Bënë urimet përfaqë-

suesit e pushtetit vendor të Vlorës, Kryetari i Bashkisë z. Dritan Leli, si dhe përfaqësues fetarë zotërinjtë: Bilal Bodlli, myftiu i Vlorës, nga orthodoksët, At Kostadin Prifti dhe katolikët, Padre Stefano Lucaçi, duke nxjerrë në pah vlerat e harmonisë fetare që shpërndan tarikati bektashian, si edhe mesazhet atdhetarë që përcjellë

Me vlerë të veçantë ishin mendimet dhe sugjerimet e grupit të punës për një mikromuze për prezatimin e veprimtarisë historike të teqesë Kuzum Baba dhe teqet e Gjyshatës së Vlorës në vite nga Kreshnik Harshova dhe Enver Kushi. Pjesëmrrësit u larguan nga vendi i shenjtë me dashurinë dhe respektin, dhe shpresën e besimit të Zotit. Ngjarje të tilla të mëdha bektashinjtë kanë ditur t'i shndërrojnë në energji për tu përballur me realitetet që kalojnë.

Vatër drite e përjetshme

Kremtohet 110 vjetori i çeljes së shkollës së parë shqipe të Tepelenës në teqenë bektashiane të Koshtanit

Dita e bekuar e pelegrinazhit të sotëm, ka mbledhur klerikë, besimtarë, myhibë bektashianë, por edhe autoritete të pushtetit vendor, me respektin më të thellë për këtë vatër ku qiriri i Haxhi Bektash Veliut, që më 15 tetorin e vitit 1908 e deri më sot, bënte dhe shpërndan dritë urtësie dhe diturie. Janë shumë fakte që i kanë dhënë kësaj teqeje fatin e madh të çeljes së shkollës së parë shqipe. Disa flasim për konceptin gjeografik. Në lartësi të tilla turqit nuk ngjiteshin lehtë. Të tjerë rrëfejnë se ishin luftëtarë të Toçit, Komçishtit apo Amerikës që merrnin në çdo moment në mbrojtje nxënësit dhe klerikët e teqesë. Ndërsa të tjerë ja atribuojnë këtë ngjarje madhore baba Ahmet Resulit. Mund të jenë të gjitha nga pak, të bashkuar në devizën emblematike bektashiane se atdheu dhe feja jetojnë vetëm së bashku.



Ka qenë 15 tetori i vitit të largët 1908, kur çuditërisht në mejdanin e teqesë së Koshtanit, në prani të baba Ahmetit dhe dervishëve të tij, u ulën në vend të myhibëve, dhjetëra nxënës që do të mësonin gjuhën e bukur shqipe. Ishte shkolla e parë shqipe që çelej në gjithë vilajetin e Janinës ndaj dhe nxënësit do të vinin nga e gjithë Shqipëria e jugut. Në mejdan, sigurisht kanë qenë dy flamurë, ai kuqezi i lashti dhe flamuri i

gjelbër i Ehli-Bejtit, që me heshtjen solemne të tyre kanë mbajtur mbërthyer vështrimet naivë por të mrekullueshëm të djemve. Nuk ka pasur asaj kohe muzikë, recitime dhe oratori që do të paraçilnin këtë ditë të bekuar, por ka qenë sigurisht zëri i butë i baba Resulajt nga fshati Mavrovë i Vlorës, i cili duke kënduar syren kuranore për dijen, ka përcjellë një prej gëzimeve më të mëdha në atë kohë, grykave dhe maleve, duke trembur mjegullën e gjatë otomane.

Sipas mistikëve, mësimi i dijeve shkollore shkon kurdoherë së bashku me mësimin e dijeve fetare. Kurani i vyer, mësimet e dymbëdhjetë imamëve, gurra e pashterur e mendimit të Haxhi Bektash Veliut, janë thesare të pafundme të atyre të fshehtave, të cilët mund të bëhen të tuajat një ditë, vetëm ke kaluar etapet e maturimit ndjesor dhe pastrimit shpirtëror.



Dituria është një thesar i tillë që për ta shtënë në duar, së pari të mendosh për ta zbratur shpirtin nga nevsia, nga gjërat tokësore, sepse vetëm një shpirt i zbratur nga nevsitet, është i gatshëm të marrë dituritë e përjetshme. Vetëm ata, të çliruar nga gjërat e padobishme, nga meritë e errëta, nga fjalët e dëmshme, mund të njohin fshehtësitë dhe mund të shndërrohen në burime urtësie. Veçanërisht në prag të shekullit që kaluam, djem të tillë i duheshin kombit dhe një

barrë të tillë edukimi morën mbi vete baballarët e teqeve bektashiane.

Dita e bekuar e pelegrinazhit të sotëm, ka mbledhur klerikë, besimtarë, myhibë bektashianë, por edhe autoritete të pushtetit vendor, me respektin më të thellë për këtë vatër ku qiriri i Haxhi Bektash Veliut, që më 15 tetorin e vitit 1908 e deri më sot, bënte dhe shpërndan dritë urtësie dhe diturie. Janë shumë fakte që i kanë dhënë kësaj teqeje fatin e madh të çeljes së shkollës së parë shqipe. Disa flasin për konceptin gjeografik. Në lartësi të tilla turqit nuk ngjiteshin lehtë. Të tjerë rrëfejnë se ishin luftëtarë të Toçit, Komçishtit apo Amerikës që merrnin në çdo moment në mbrojtje nxënësit dhe klerikët e teqesë. Ndërsa të tjerë ja atribuojnë këtë ngjarje madhore baba Ahmet Resulit. Mund të jenë të gjitha nga pak, të bashkuar në devizën emblematike bektashiane se atdheu dhe feja jetojnë vetëm së bashku.

Miku im, Rait Rama, më rrëfen se si në fëmijëri vinte këtu dhe gjente paqen e mahnitshme. Myhibi i vjetër Et'hem Resuli më tregon se ç'gëzim ndjenë kur morën vesh se teqeja do të shndërrohej në shkollë pas vitit 1968. Të paktën nuk do të rrënohej e dhunohej si teqetë e tjera. Ndërsa dervish Xhelal Resuli, u kujton ditët e para të shkurtit 1990, kur se bashku me Asllan dhe Dasho Qendron erdhën pranë këtyre rrënojave, duke u dhënë krejt besimtarëve aty, lajmin e madh, se teqeja shumë shpejt do të çelej. Ndërsa baba Abdyl Shehaj, flet për dy dekada përpjekje në vijimësi jo vetëm për të ngritur ndërtesën kryesore të teqesë historike, por edhe për të rikthyer besimin në Zot tek njerëzit e pafajshëm të diktaturës që kaluam.

Tingujt e himnit të flamurit kanë fashitur këngët labe dhe bisedat. Pastaj e merr fjalën Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili tha midis të tjerave: "... Së pari, më lejoni t'ju falënderoj që kemi ardhur sot në teqenë e Koshtanit, në këtë vend të bekuar dhe dua t'u përcjellë në cilësinë e Kryegjyshit Botëror Bektashian, urimet më të mira për ju dhe familjet tuaja. Zoti i Lartë u plotësoftë dëshirat! Prej më shumë se dy dekada, çdo 15 tetor na ka mbledhur tek kjo teqe, dëshira jonë e përbashkët për të sjellë ndërmend të kaluarën e saj, dervishët dhe baballarët që kanë shërbyer dhe shërbejnë, myhibët tanë të përkushtuar që pa zhurmë e pa bujë ecin nëpër udhën e Hakut, duke rrezatuar paqe, përkushtim dhe mirësi. Jemi mbledhur, i jemi lutur Zotit të Lartë në heshtje, kemi dëgjuar



zërat e myrshidëve tanë, kemi qarë hallet dhe kemi gëzuar së bashku. Besoj se askush nga ne s'e ka haruar se në përvjetorët e parë të ringritjes së kësaj teqeje, ka qenë midis nesh i paharruari, shëmbëlltira më fisnike e bektashizmit, Haxhi Dede Reshat Bardhi. Zoti e shenjtëroftë misterin e Tij! Por dita e sotme, 15 tetori i vitit 2018, mbart brenda vetes një simbolikë të veçantë. I 10 vjet më parë, dyert e drunjtë të kësaj teqeje, ato dyert aq të dashura për mijëra besimtarë jo vetëm nga Tepelena por edhe Mallakastra, Gjiokastra, Vlora e Përmeti, u çelën për nxënësit e të parës shkollë shqipe në këtë trevë. Së bashku me dijet për Zotin, nxënësit e atij shekulli aq të

trazuar për Shqipërinë, do të mësonin dijet e historisë, gjeografisë dhe gjuhës së bukur shqipe, e cila ndonëse e lindur pesë shekuj më parë, ishte sulmuar aq barbarisht nga otomanët dhe të tjerë. Tanimë, nga historiografia jonë por edhe nga ajo Evropiane, është pohuar gojë plotë fakti se gjatë periudhës së lëvizjes autonomiste shqiptare, teqetë bektashiane u shndërruan në vatra të përhapjes dhe mësimin të gjuhës shqipe. Librat e Haxhi Bektash Veliut ishin dhe mbetën të bashkuar në sepetet e baballarëve tanë, duke dëshmuar se Zoti dhe kombi nuk mund të mohohen. Kjo devizë madhështore ka mbrojtur jo vetëm mendimin por edhe veprimin bektashian të atyre viteve. Është folur shumë ndërkaq edhe për përpjekjet e

baballarëve tanë për alfabetin me germa latine, madje disa prej tyre dhanë jetën për libra me alfabet të tillë. Nëse e kthejmë vështrimin pas në ato kohëra, shohim qartë se lëvizja jonë atdhetare kombëtare në bashkëpunim me institucionet bektashiane, e kishte të qartë se fatet e atdheut vendoseshin me pushkë dhe penë. Ata ishin të ndërgjegjshëm gjithashtu se gjuha shqipe, largimi ynë i gjithëkohshëm nga zgjedha otomane, do të ishte shenja më domethënëse për t'iu afruar familjes natyrore Evropiane, të cilës i përkisnim në të vërtetë. Teqeja e Koshtanit ishte vënë plotësisht në funksion të shqiptarizimit, prandaj ajo u dogji herë, nga andartët grekë dhe forcat esadiste, ndryshe dervishët dhe baballarët e saj u burgosën



dhe u vranë. E themeluar në vitin 1807, prej baba Sadik Horasani, teqeja e Koshtanit do të ndiqte rregullat e pashkruara të çdo teqeje bektashiane. Ajo do të mbështetej në rimëkëmbjen e saj në mënyrë të veçantë nga banorët e trevës përfaqë, të cilët nën ndikimin e dervishit apo babait të teqesë, do të shtronin besimin e tyre në Zot jo në mënyrë të verbër, por duke lidhur në mënyrë harmonike doktrinën fetare, me shqetësimet e kombit të tyre. Pas baba Sadik Horasanit të ardhur nga teqeja e famshme e Haxhi Bektash Veliut, ishte baba Ismaili nga lagja Ruçaj e këtij fshati, për të vijuar më tej me baba Muharrem Allkomemaj dhe për të mbërritur tek baba Ahmeti nga Mavrova e Vlorës, kontributi i të cilit është mjaftë i njohur.

Me jetën dhe veprën e baba Ahmetit lidhet padyshim ngjarja kombëtare e çeljes së shkollës së parë shqipe për këtë trevë, nga ku morën dijet e para ata luftëtarë lirie që mbushën radhët e luftëtarëve në të gjitha përpjekjet shqiptare të viteve 1908-1925. Historiografia jonë sigurisht do të thotë fjalën e saj edhe për Kongresin e Gjuhës Shqipe të mbajtur në Koshtan, i cili për nga rëndësia vjen sigurisht pas atyre të Manastirit dhe Elbasanit. Në vitet që rrodhën më pas, deri në vitin e mbrapshtë 1967, teqeja e bekuar e Koshtanit mbeti vatër e pashuar e besimit në Zot, e gjuhës shqipe, e përhapjes së dijeve dhe ndjenjave më të vyera kombëtare. Ne përulemi sot me respektin më të thellë ndaj baba Kaso Veizaj, baba Shefqet Gllava, dervish Ibrahim Ruçaj, dervish Arshi Bazaj, baba Abedin Merko, baba Abedin Agaj, baba Adem Mahmutaj, baba Fejzi Koshtani, baba Kasëm Koshtani, dervish Muharrem Koshtani, dervish Qazim Koshtani, dervish Xhafer

Me jetën dhe veprën e baba Ahmetit lidhet padyshim ngjarja kombëtare e çeljes së shkollës së parë shqipe për këtë trevë, nga ku morën dijet e para ata luftëtarë lirie që mbushën radhët e luftëtarëve në të gjitha përpjekjet shqiptare të viteve 1908-1925. Historiografia jonë sigurisht do të thotë fjalën e saj edhe për Kongresin e Gjuhës Shqipe të mbajtur në Koshtan, i cili për nga rëndësia vjen sigurisht pas atyre të Manastirit dhe Elbasanit. Në vitet që rrodhën më pas, deri në vitin e mbrapshtë 1967, teqeja e bekuar e Koshtanit mbeti vatër e pashuar e besimit në Zot, e gjuhës shqipe, e përhapjes së dijeve dhe ndjenjave më të vyera kombëtare. Ne përulemi sot me respektin më të thellë ndaj baba Kaso Veizaj, baba Shefqet Gllava, dervish Ibrahim Ruçaj, dervish Arshi Bazaj, baba Abedin Merko, baba Abedin Agaj, baba Adem Mahmutaj, baba Fejzi Koshtani, baba Kasëm Koshtani, dervish Muharrem Koshtani, dervish Qazim Koshtani, dervish Xhafer Koshtani, baba Myrteza Tinari etj, të cilët jo vetëm që mbajtën gjallë frymën e atdhetarizmit, por edhe bënë ç'është e mundur të edukonin breza të tërë me ndjenjat e solidaritetit dhe vëllazërisë sonë fisnike.

Koshtani, baba Myrteza Tinari etj, të cilët jo vetëm që mbajtën gjallë frymën e atdhetarizmit, por edhe bënë ç'është e mundur të edukonin breza të tërë me ndjenjat e solidaritetit dhe vëllazërisë sonë fisnike. Unë gjej sot rastin të falënderoj gjithë popullin e Koshtanit dhe Tepelenës, të cilët me shpirtin e mrekullueshëm njerëzore, bënë që tarikati bektashian të rritet e të forcohet dita-ditës në lartësitë e këtyre majave. Gjithashtu, falënderoj nga zemra vëllanë tuaj dhe timin baba Abdyli Shehaj, i cili qysh në ditët e para të ringritjes të bektashizmit pas vitit 1990, iu përkushtua tërësisht veprimtarisë fetare duke kontribuar në mënyrë të veçantë në teqenë e Koshtanit, në atë të Memaliajt dhe sot në teqenë e Zallit në Gjirokastrë. Punofsh kurdoherë të mira vëllai ynë baba Abdyli! Ndërkaq mendoj se përvjetorë të tillë, duhet të na vlejné të gjithëve jo vetëm sepse kujtojmë të kaluarën tonë, sado e lavdishme të jetë ajo. Këto bashkëbisedime le të na vlejné për më shumë shpresë për të ardhmen tonë, për më shumë dashuri ndaj njeri-tjetrit, ndaj prindërve tanë, ndaj vetë Shqipërisë. Zoti i Lartë, Haxhi Bektash Veliu kështu duan të na shohin së bashku, si vëllezër të pandarë. Zoti ju bekoftë të gjithëve!”

Përsëndet paskëtaj Prefekti i Gjirokastrës, z. Astrit Aliaj, Kryetari i Bashkisë Tepelenë z. Tërmet Peçi, Kryetari i Bashkisë Memaliaj, z. Durim Roshi, studjuesi z. Xhezo Cana, të



cilët nxjerrin në pah kontributin e çmuar të kësaj teqeje si në aspektin fetar, ashtu edhe kombëtar, duke u ndalur sidomos në çeljen e shkollës së parë shqipe për gjithë këtë trevë. Nuk ka munguar të përsëndesë sigurisht edhe baba Abdyl Shehaj, i cili ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit që kanë ardhur për të ndarë emocionet e këtij jubileu të lavdishëm. Më tej, nga Selia

e Shenjtë Bektashiane janë dhënë disa mirënjohje myhibëve të kësaj teqeje, për kontributin e shquar të tyre sidomos në këtë çerek shekulli të fundmë. Për të ardhur më pas tek këngët labe, të interpretuara mjeshtërisht dhe të dhuruara enkas për këtë ditë.

Syrja Xhelaj,
Koshtan, tetor 2018



Tek drita tek qiparisi, Del na pret baba Idrizi!

Me Merqez Spahajn, ndonëse kam tridhjetë minuta që bisedoj, më duket se e kam njohur prej kohësh. Ruan kujtime të vyera për Bënçën dhe sidomos për këtë vend të shenjtë, ku pas 40 vitesh u ringrit një tyrbe e re, përmes një gjelbërimi që merr jetë nga dashuria njerëzore. Nerqrezi ndalet në mënyrë të veçantë në ato ditë-skëterrë, ku “po të zije në gojë baba Idrizin, të zinte gjarpri i partisë nga gryka”. Dhe me vështrimin në majën e Buzës së Bredhit më rrëfen se para vitit 1967, mekani këtu ishte të paktën mes luleve dhe pemëve.

Natën ndriçonin qirinjtë ndërsa ditën çdo bënçiot që nisej për në Tepelenë apo gjetkë, përkëdhelte gurët e bardhë. Në mbretërinë e shpirtit gjenden qiej, thonë mistikët e hershëm. Tek ajo përkëdhelje e gurëve në vendin ku prehet përjetësisht baba Idrizi, qiejt jepnin e merrnin me sinjale gjithfarësh duke paradhënë dashurinë ndaj Krijuesit.

Përmes rrëfimesh më duket sikur zbret nga shtëpia, ajo grua e mpakur nga mosha, por me bukurinë emblematike të së dashuruarës me Zotin. E quajnë Amali dhe është bijë nga dera e bekuar e Jaupajve, fare pranë

mezarit të baba Idrizit. E kishte parë mezarin të humbiste mes degëve, vijon xha Merqezi, dhe i pati ardhur ligisht. Kishte marrë një kotorre kur qe errur dhe kishte prerë degë e driza. Pastaj kishte marrë gëlqere dhe me merakun e një nikoqireje të urtë kishte lyer gurët nga fillimi në krye. Rrofsh moj bijë, i thanë ata që e panë, marrsh uratat e baba Idrizit. Por ishin kohë të këqija. Dikush raportoi në organizatën e partisë së fshatit dhe u mblodh në çast brigada. Amalia duhej demaskuar se ndërkohë që partia ishte ngritur kundër fesë, ajo donte të ngjallte kujtimin e baba Idrizit. E di ç'ndodhi? Ndonëse Amalinë e kritikuan, qirinjtë natën tek mezari ndriçonin më shumë sikur t'i kishte shtuar me dorën e tij, Haxhi Bektash Veliu. Në pritje të ceremonialit në nderim të ringritjes së tyrbes, dervish Mikel Oneja bisedon me besimtarët e

mblodhur enkas. Aty pranë është dhe grupi i famshëm polifonik i Bënçës, me të cilin jo rrallë është identifikuar e djeshmja dhe e sotmja e këtij fshati. Ata ja marrin këngës dhe një gjimnaziste e pyet dervishin se ç'do të thotë ai vargu "...tek drita, tek qiparizi.". Ky buzëqesh dhe i thotë se çdo mezar, çdo tyrbe bektashiane është në të vërtetë një burim drite. Sa mjegulla, sa shira dhimbjesh, sa stuhi kanë kaluar tek ky shteg, pranë këtij mezari dhe në natën më të thellë, aty nuk reshti drita. Pastaj dervishi thotë me zë të lartë një lutje të Profetit tonë: O zoti im! Vendos një dritë në zemrën time, një dritë në mendimin tim, në shikimin tim, në kockat e mia, në gjakun tim, në të djathtën time. Shtojë dritën time, bëmë mua dritë, o Drita e dritës, me mëshirën Tënde!

Kanë përshëndetur të gjithë me fjalë zemre. Ka marrë fjalën paskëtaj dhe Kryegjyshi Botëror Bektashian,

Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili tha: "... Të nderuar besimtarë të mrekullueshëm të Bënçës dhe gjithë Tepelenës! Më lejoni t'ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë veprimtari tonën duke ju dhënë bekimet më të mira ju dhe familjeve tuaja. Zoti i Lartë ua shpërbleftë mirësitë tuaja në të dy botët! Është kënaqësi e veçantë të mblidhesh në çaste të tilla kaq solemne, ku vargut të teqeve dhe tyrbeve në Shqipëri dhe në botë i shtohet një tyrbe e re.. Është po kaq kënaqësi kur tyrbja e ngritur lidhet me një nga emrat e spikatur të tarikatit tonë, në jugun e Shqipërisë, baba Idriz Bënçës, jeta dhe vepra e të cilit janë të lidhura ngushtë me fatet e bektashizmit në shekujt 17 edhe 18. Kënaqësia buron ndërkaq edhe nga fakti se klerikë si baba Idrizi, me një forcë të pakrahasueshme shpirtërore, me mrekulli që janë përcjellë nga brezi



Zoti i Lartë ua shpërbleftë mirësitë tuaja në të dy botët! Është kënaqësi e veçantë të mblidhesh në çaste të tilla kaq solemne, ku vargut të teqeve dhe tyrbeve në Shqipëri dhe në botë i shtohet një tyrbe e re.. Është po kaq kënaqësi kur tyrbja e ngritur lidhet me një nga emrat e spikatur të tarikatit tonë, në jugun e Shqipërisë, baba Idriz Bënçës, jeta dhe vepra e të cilit janë të lidhura ngushtë me fatet e bektashizmit në shekujt 17 edhe 18. Kënaqësia buron ndërkaq edhe nga fakti se klerikë si baba Idrizi, me një forcë të pakrahasueshme shpirtërore, me mrekulli që janë përcjellë nga brezi në brez, ndonëse kanë pasur kërkesa të ulen në poste të larta të teqeve të kohës, nuk kanë pranuar.

Ata e deshën vatanin e tyre me shpirt, ndaj çdo veti dhe forcë të shpirtit të tyre e vunë deri në fund, në shërbim të vatanit, të vëllezërve dhe motrave të tyre bektashianë. I mëkuar qysh në fëmijërinë dhe rininë e hershme të tij me 'bëmat' e bënçiotëve kundër hordhive otomane, Idrizi do të edukohet me shpirt të lirë dhe krenar. Bënça dhe krahina e Tepelenës, në shekujt 16 dhe 17 adhuronte tarikatet e Islamit, ku bektashizmi zinte vend të nderuar. Tepelenasit do ta dhuronin Haxhi Bektash Veliun i cili porosiste që krahas detyrimeve të tjera të Zotit, ishte me po aq rëndësi edhe lufta për çlirimin e vatanit, ashtu sikundër do të adhuronin Imam Aliun kur linte të shkruar shprehjen historike:

"O njeri, ke lindur i lirë prej nëne dhe babe, mos u bëj rob i askujt!". Sipas ligjeve otomane, Idrizi 17 vjeçar thirret ushtar në Anadoll dhe meqenëse bektashizmi ishte shumë i përhapur në ata shekuj atje, djali nga Bënça i përkushtohet udhës së Hakut.

në brez, ndonëse kanë pasur kërkesa të ulen në poste të larta të teqeve të kohës, nuk kanë pranuar. Ata e deshën vatanin e tyre me shpirt, ndaj çdo veti dhe forcë të shpirtit të tyre e vunë deri në fund, në shërbim të vatanit, të vëllezërve dhe motrave të tyre bektashianë. I mëkuar qysh në fëmijërinë dhe rininë e hershme të tij me 'bëmat' e bënçiotëve kundër hordhive otomane, Idrizi do të edukohet me shpirt të lirë dhe krenar. Bënça dhe krahina e Tepelenës, në shekujt 16 dhe 17 adhuronte tarikatet e Islamit, ku bektashizmi zinte vend të nderuar. Tepelenasit do ta dhuronin Haxhi Bektash Veliun i cili porosiste që krahas detyrimeve të tjera të Zotit, ishte me po aq rëndësi edhe lufta për çlirimin e vatanit, ashtu sikundër do të adhuronin Imam Aliun kur linte të shkruar shprehjen historike: "O njeri, ke lindur i lirë prej nëne dhe babe, mos u bëj rob i askujt!". Sipas ligjeve otomane, Idrizi 17 vjeçar thirret ushtar në Anadoll dhe meqenëse bektashizmi ishte shumë i përhapur në ata shekuj atje,



djali nga Bënça i përkushtohet Udhës së Hakut. Kanë qenë sigurisht mrekullitë e shfaqura prej tij, çfarë bënë që baballarët ta dorëzonin në teqenë e Haxhi Bektashit, ku ai mori mësimet e para fetare. Gjithashtu, sipas kodeve zakonore bektashiane, dervish Idrizi udhëton nëpër vendet e shenjta që lidheshin me emrin e shenjtë të Profetit tonë të bekuar dhe dymbëdhjetë imamëve, duke u thëlluar sidomos në brendësi të këtyre vendeve, në filozofinë dhe

shkëlqyer të Jugut të Shqipërisë. Roli i baba Idrizit në këtë kontekst është mjaft i spikatur jo vetëm për mrekullitë e rrëfyera, por edhe për faktin se ai iu bashkua plejadës së madhe të dervishëve dhe baballarëve bektashinj të trevave shqiptare, në lëvizjen për një doktrinë fetare sa më të devotshme ndaj Krijuesit, aq edhe më pranë halleve e brengave të kombit që lëngonte nën zgjedhën otomane.

Selia e Shenjtë Bektashiane po

e kësaj tyrbeje të re, brenda së cilës gjendet mezari i baba Idrizit. Unë dua t'ju kujtoj të gjithëve sot, që Allahu i Lartë ka thënë se "Kush përpiqet e ndërton një shtëpi të Zotit në këtë botë, unë i ngre atij pallate me kopshte të lulëzuara në xhenet." Një falënderim të veçantë kam sot për vëllanë tuaj dhe timin, dervish Mikel Oneja, i cili me përgjegjësinë e plotë të postit që ka, por edhe me sakrificat e mbështetjen tuaj, me ringritjen e teqesë së Turanit, të tyrbes në Qafë-Kreshtë dhe të sotmes këtu në Bënçë, po i bën një shërbim të vyer tarikatit tonë në këtë trevë.

Kurrë mos u lodhshim, të gjithë së bashku, në ringritjen e besimit tonë të mrekullueshëm...!"

Si një thirrje për vëmendjen ndaj besimit bektashian ka qenë edhe përshëndetja e dervish Mikelit. Ai përmend emrat e besimtarëve që iu bashkëngjiten nismës për ngritjen e tyrbes së baba Idrizit, duke përcjellë jo thjeshtë bujarinë e tyre, por sidomos devocionin ndaj këtij tarikati që në 800 vite të jetës së vet u mbajt gjallë me frymën e tyre dhe të klerikëve. Çdo gurë i kësaj tyrbeje, përpara se të jetë djersë nga e juaja, vijoi dervishi, është dhimbje nga e juaja, kur shihnit të venitur kujtimin e baba Idrizit, siç është sigurisht gëzim nga ky i sotmi. Së bashku me tyrben në Qafë-Kreshtë por edhe me tjetrën që do të ringremë këtu në Bënçë, tyrbja e baba Idrizit do të ndjehet jo më e vetmuar. Këto tyrbe, padyshim do bëjnë më të lehtë jetën dhe do na shumëfishojnë shpresën. Le t'i mbajmë sytë nga këto vende të mira sepse vetëm të mira do të shohim. Le ta duam më shumë njeri-tjetrin se në këto kohëra që po kalojmë, vetëm dashuria për Zotin dhe njeri-tjetrin na mbajnë për dore dhe të bashkuar deri në frymën e përjetshme.

**Syrja Xhelaj, - Bënç,
Tetor 2018**



urtësinë që ato shpërndanin. Pas këtyre udhëzimeve, sipas disa të dhënave, Idriz Bënça merr titullin "baba" dhe i jepen poste të larta në disa teqe, por ky pati thënë se "s'mund ta ndërroj Bënçën time me asnjë teqe në botë".

Me ardhjen e tij në Bënçë, sigurisht që tarikati bektashian do të fitonte territore të reja, çfarë do të përgatisnin besimtarë që do të çelnin më pas teqe në Krahës, në Gllavë, në Kapaj etj, të cilat vite më vonë në ndërthurje harmonike me teqetë e Turanit, Melanit, të Gjirokastrës dhe Përmetit, do të përbënin mozaikun e

ndërmerr hapa konkretë në kontekst të fakteve historikë rreth këtij tarikati jo vetëm në trevat shqiptare, por edhe në Ballkan, Europë dhe Azi. Në këtë ide ne sigurisht do të këmbëngulim për të ndriçuar edhe jetën dhe veprën e baba Idriz Bënçës, e këtij misionari bektashian që i parapriu epokës së begatë të lulëzimit të teqeve me ndihmën e drejtpërdrejtë të Ali Pashë Tepelenës. Por unë dua të falënderoj sot të gjitha familjet e Bënçës, të këtij fshati me histori të mrekullueshme, të cilat kontribuan me çdo mundësi të tyre për ngritjen

NJË POETE FRANCEZE DHE DERVISHËT SHQIPTAR

Luan Rama - Paris

Dervishi, përballë saj... Në heshtjen e dhomës dhe meditimin e gjatë. Një dialog nën zë, ndërkohë që ajo shkruan vargje. Poetja dhe dervishi. Dervishi otoman, zbarkuar në Paris nga miku i saj, piktori Omer Kaleshi. Dervishi që e ka lënë teqenë e tij, dhe ka ndalur aty në dhomën e saj, një ditë të vitit 2012, ku qëndron ditë e natë brenda një kornize, duke e parë atë me sytë e tij të mbyllur.

«Edhe pse symbyllur, dervishi shikon» – thotë piktori.

E kisha fotografuar atë dervish në atelierin e piktorit, kur ai e kishte zbritur atë nga kavaleti i tij i vjetër dhe e kishte vendosur në kornizë. Pastaj një ditë, dervishi, kishte shkuar të gjente një strehë tjetër, më të gëzuar e femërore, një strehë të përherëshme, dhomën e poetes që e shikonte me aq kërshtëri, poetes që i kishte kënduar aq shumë: « ... dervishi ballë shtratit tim nuk është në të zeza veshur me të bardha është gati të vijë rrotull por ai nuk rrotullohet është gati për ekstazën e tij ai qëndron i qetë dhe i paqtë aty duke pritur ceremoninë... ». Gjithçka kishte një shije dashurie, apo diçka më shumë: sublimja e ngjyrës, figurës dhe fjalës, e poezisë me pikturën, për çka aq shumë kishte shkruar dhe i madhi Leonardo Da Vinti. Atje në atelierin e tij krijohet mrekullia.

A nuk ka shkruar ajo për tablotë e tij se: «Mrekullia mbahet veç në një fill ku ti var nga një breg në tjetrin peshq dhe koka virgjëresha dhe barinj një lot alkimik... » Ja ku kam ardhur tashmë në sallonin e mikes time Laure Cambau. Dervishi nuk është vetëm. Jemi tre. Ai rri i heshtur dhe dëgjon fjalët



tona për atin e tij, krijuesin e tij, Omer Kaleshin. Kur Laure u njoh me Kaleshin dhjetë vjet më parë, kur kisha organizuar ekspozitën e madhe të tij në hollet e bashkisë së Parisit XIII, ky piktor e habiti me kokat e shumta të tij: Omeri i kokave. Vallë përsëri një poemë homerike në kohët moderne?

Shpejt poetja e adhuroi dhe krijuesin e kokave. Ngjiste shkallët e shumta të katit të shtatë atje në bulevardin Arago. Shkonte të shikonte kokat e reja,

barinj e dervishë, vajza që shisnin fruta, çobanë të rinj, personazhe të dramës së fundit ballkanike, fëmijë, fytyra ballkanasish të vjetër e të rinj. Atje, në atelier, ajo shijonte dhe rakinë e tij, dhe heshtjen e tij, pasi Omeri flet pak, ose aspak... një "heshtje memecë", siç e cilësonte miku i tij, filozofi Jacques Lacarriere, i cili po ashtu i kishte kushtuar shumë poezi kokave të tij. Dhe kështu, poetja zbriste pastaj ato shkallë "qiellore" për të shkuar në shtëpinë e saj apo në kafene, për të shkruar vargjet e saj. Kokat e Omerit rijetonin kësaj radhë brenda vargjeve: "Një podium kokash të vendosura e të futura bashkë një kokë e madhe mbi dy koka dy koka të vogla mbi një të madhe pesëmbëdhjetë koka kokëforta që bëjnë veç me kokë

të tyre e nganjëherë të bijen mbi kokë!...".

Dhe kështu, njëra pas tjetrës ajo krijoi nëntëmbëdhjetë poezi. Atëherë po përgatisja një libër me titull "Fjala e Omerikëve", duke përmbledhur poezitë e poetëve të ndryshëm, miq të piktorit, si poetë francezë, shqiptarë, turq, maqedonas. Aty u vendosën edhe poezitë e Laure-s: një poezi, një tablo. Pas botimit të këtij libri në frëngjisht, shqip dhe maqedonisht, Laure Cambau do të vazhdonte udhëtimin e saj poetik nga atelieri i piktorit në sallonin e saj në Rue Damesme. Poezitë shtoheshin dhe kur takoheshim, unë shpesh e pyesja nëse kishte ende ndonjë poezi të re për mikun e saj. Dhe ajo m'i dërgonte për të shuar kureshtjen time: "Kam ëndërruar

se më pikturoje dhe unë kisha frikë në të bardhën e telajos..." Këto poezi u botuan në librin poetik të saj Letra vagabondit qiellor të shtëpisë botuese Editions de l'Amandier, një vëllim i ndarë në dy blloqe poetikë, ku blloku i dytë E bardha pa të bardhë i kushtohet Omerit dhe tablove të tij. Dhjetra poezi kushtuar Omer Kaleshit.

Por përsëri, kjo aventurë poetike, nga atelieri i bulevardit Arago, në Vavin, Denfert Rochereau apo në Buttes aux Cailles, etj, e pastaj do të vazhdonte në mbrëmjet e vona në Rue Damesme. Kështu u krijuan poezitë e tjera si sytë e triptikut, mbi sytë e mi, tabloja e të katërve, përse dy data – palimpsest, etj. E kuqe me të kuqe, e zezë pa të zezë... një paletë ngjyrash poetike ngjizur në vargje, si në një pjatancë



frutash të Chardin. Piktori gjithnjë e befasonte atë me krijimet e reja të tij, por dhe poetja e befasonte piktorin me vargun e saj. Dhe ishte ai tani që më përcillte poezinë e saj më të fundit, një poezi pas tjetrës: «Merre, lexoje... bukur!»...

Dhe kështu lindi idea e këtij libri poetik, ku çdo poezi do të vendosej përkrah tablosë që e kishte frymëzuar atë, përcjellë nga frëngjishtja në shqip, nga njëri cep i urës gjigante në tjetrën, nga Parisi në Tiranë, në sofrën poetike të Rita Petros... Laure shikonte nuancat e së kuqes, humbiste në të kuq si në ujërat e një deti dhe në mëndje i vinte historia e asaj ngjyre pas së cilës ishte kapur aq shumë ai piktor: ngjyra e përzgjedhur e tij që në vitet e Akademisë së Arteve të Bukura në Stamboll: «Ti bën zjarr me çdo dru nga druri i spatulës tek druri i kavaletit nga këto flakë lind qielli i tablove të tua tabloja që mbushet me gjakun tënd në kufirin e së kuqes dhe të hapësirës nga hauri tek thertorja fëmija rritet dhe në ditët që zgjohen kërkon ngjyrën e zjarrit gjaku thahet në tas dhe në porta në këmishët dhe në koka spatula vazhdon udhën e saj...».

Në atelierin e Omerit, çdo detaj kishte për të një domethënie. Shpesh gjendeshim të tre, ulur në minderet otomane, para një rakie që ia sjell piktorit gjithnjë nga Shqipëria. Ajo vështronte atelierin dhe humbiste në detajet dhe imazhet e çuditshme të një jete, të një historie, në atë Ballkan të vockël, të rikrijuar aty, në katin e shtatë, buzë reve, në prag të qiellit dhe gjithësisë, në natën e yjësuar... Përse ai kolltuk i rëndë prej druri i piktorit bërë nga duart e tij? Përse ajo musandër, ajo tabelë plot manometra

elektrikë të një bote të shkuar, ato kukulla dervishësh, etj, përse syreti i gjyshit i varur në mur, figurinat në miniaturë të çobanëve, shportat ku ai imagjinonte të vendoste kokat e tij, ajo këmbë allçie që varej në tavan të atelierit apo ikona e kokës së prerë të Gjon Pagëzorit?...

Njëmijë "përse" të saj si njëmijë shkallë për tu ngjitur e zbuluar jetën e një njeriu, e një artisti. Dhe kështu, duke kërkuar domethënien e një date, një ngjarje, dhimbje e dashurie, ajo e ktheu këtë histori njerëzore në një poemë të gjatë që s'dihet kur do të mbarojë, pasi piktori është e habitshëm, poetja gjithashtu! Gjithnjë do të ndeshesh me një të papritur. Laure Cambau është një poete e njohur në rrethet letrare e poetike franceze. Disa çmime ndërkombëtare ndër të cilat dhe çmimet "Poncetton" të SGDL (Shoqatës së të Drejtave Autorëve) për librin e saj Letra vagabondit qiellor më 2010 apo "Simone Laundry", më 2015, etj, dëshmojnë statusin e kësaj poete në poezinë franceze e frankofone në përgjithësi. Poezinë ajo e përqafoi që në fëmijërinë dhe adoleshencën e saj, kur shtatë vjeçare shkroi poezitë e para e më pas tekste këngësh, kohë kur luante sonatat e para të Chopin në pianon e vjetër familjare. Ishte biblioteka e madhe e prindërve dhe ajo botë librash që do t'i shpaloste magjinë e leximit dhe të krijimit, dhurata e nënës për ditëlindje me një vëllim të Baudelaire në "Pleiade" të Gallimard. Kështu Baudelaire u bë shpejt i preferuari i saj, ylli polar poetik. Pastaj Verlaine, Rimbaud...

Më vonë poetë të tjerë trokitën në dritaret e shpirtit të saj: Max Jacob, Eluard, Lorca... Çuditërisht dhe një poet mistik spanjoll:

Jean de la Croix apo vetë figura e shenjtës Thérèse de Lisieux në Normandi. Poetë, mistikë dhe shenjtë... shenjtë të të gjitha feve dhe kombeve. Libri i parë poetik Bulevarde lunatike, u botua në Editions Brocéliande, në vitin 1998, ku poezitë e saj ilustroheshin dhe me fotot e botuesit. Ishte padyshim një ngjarje në jetën e saj duke e frymëzuar për të ngjitur më shpejt shtigjet e reja poetike. Laure Cambau është gjithashtu pianiste. Jo rrallë ajo të fton në koncertet e saj muzikore apo ato koncerte që ka dhënë nëpër Europë, ku poezia gërshetohet me sonatat e pianos, ku luan muzikë me tekstet e Heine, Holderlin, Eluard, Hesse, Lorca... Ndoshta është dervishi i Omerit ai që e shtyu atë të merrte udhët drejt Shqipërisë dhe t'i ngjitej Malit të Tomorrit, atje ku çdo vit bëhet festa e bektashinjve, atje ku kryegjyshi botëror, Baba Mondi, bën lutjen drejtuar Zotit të Lartë. Lutje me aromë paqeje, shpirti që nuk vdes, vere dhe dashurie. Në dhomën e saj, Laure ka madje dhe një diplomë të firmosur nga dora e kryegjyshit për shfaqjen e saj në majën e Tomorrit në atë ditë plot diell të festës së madhe midis mijra besimtarëve. Ajo më tregon diplomën dhe qesh me mirësi.

Një diplomë ndryshe nga diplomat e tjera që shpërndahen në të katër anët e botës... diplomë mistike, sepse ishin dervishët që e nxitën kështu të shkruante për ta dhe për rrugëtimin e tyre të gjatë, nga Bektash Veliu në shekullin e XIII duke kaluar nëpër tokat dhe poemat e sufistit Jonuz Emré, për të ardhur në Malin e Tomorrit në Shqipërinë e vitit 2014. Legjenda thotë se një baba, morri një grusht dhé nga varri i Baba Abaz Aliut dhe

e vendosi në majën e atij mali, duke krijuar kështu një varr të dytë të shenjtë në malet shqiptare. E megjithatë, duket se jo vetëm dervishi i Omerit e nxitën atë të udhëtonte si të ishte një Aleksandra David Néel, Hester Stanhope, kontesha Gasparin që shkruante për brigjet e thepisura të Jonit shqiptar, Mary Montagy, udhëtare këto të shekullit XIX apo dhe si udhëtarët e kohëve moderne.

Ajo më tregon për profesorin e saj të historisë, kur ishte në shkollë në moshën 13 vjeçare dhe kur ai u fliste me entuziazëm për Shqipërinë maoiste dhe utopinë e një vendi që nuk donte t'ia dinte për superfuqitë dhe kjo tashmë e bën të qeshë me të madhe. Pastaj më tregon për shkrimtarin e njohur Robert Escarpit që i ati, mik i tij, gjithnjë kur e takonte e thërriste «Roberti shqiptari», i cili ishte mahnitur nga Shqipëria e «Gjeneralit të ushtrisë së vdekur».

Më pas ajo vazhdon të më tregojë për udhëtimin e familjes së saj në jahtin e një miku të afërt, kur sëbashku, nga Brindizi, ata u afroreshin brigjeve shqiptare pranë Shkodrës dhe kur shoqëruesi nxitoi t'i largonte nga ato brigje të heshtura pasi «ushtarët e Republikës së «paepur» mund ta kthenin udhëtimin e tyre në një «udhëtim funebër»... kështu, Shqipëria kishte mbetur një mit që gjithnjë e grishte, madje dhe në ditët kur do të shkonte në festivalin poetik të Strugës, aq pranë Shqipërisë mitike, «planetit të pashkelur» nga pinjollja e «princit të vogël»...

Më së fundi, atë gusht të vitit 2014, bashkë me poezitë e dervishëve të saj, ajo shkeli zbatuar në tyrben e famshme dhe të shenjtë që ngrihej atje në majë të atij mali si një observator i shenjtë i shpirtave njerëzore... Atje bashkohej dhe qielli, poezia, piktura e Omerit dhe shpirta që kishin jetuar në mijra vjet. Në dhomën e poetes, Laure Cambau tabloja e dervishit, tabloja dhuratë e piktorit, është gjithnjë aty, përballë shtratit, varur si në një qiell mistik, i pagjumë e vjgëlues, i paqtë e njëherësh si një ashik i heshtur që vështron përtej brigjeve ballkanase: «... fle dhe vallëzoi dhe ëndërroj në të bardhë dhe ballë meje një dervish më flet fjalët e tij janë karremë memecë një qumësht blu që më bën për vete në një këngë para pemëve në të djathtë kam një plagë në të majtë një «flakë të pikturuar» dhe ballë meje një dervish...

Shqiptarët... një

Nga Frances Trix-SHBA

Baba Rexhepin përmes jetës së tij të gjatë, njerëzit e kanë njohur në kohëra të ndryshme, e kanë parë nga anë të ndryshme. Këndvështrimi im është ai i një amerikaneje që ka studiuar me të mbi 20 vjet, në teqenë bektashiane të Michiganit. Sidoqoftë së pari dua të falënderoj ata shqiptarë, që aty nga gjysma e parë e shekullit XX-të erdhën e zunë vend në shtetin e Michiganit. Sepse baba Rexhebi erdhi më 1952 në këtë shtet falë këtyre shqiptarëve. Ai sërish qëndroi këtu në Michigan falë kurajos së këtyre shqiptaro-amerikanëve, të cilët i dualën krah në këto vitet e para të vështira të teqesë.


Vetë babai, vite më pas do të thosh në turqishte: «Gelenlere



ashk ollsun deme, kalanlara ashk ollsun der», që do të thotë: Mos u thuaj ashk ollsun atyre që vinë. Ashk ollsun u thuaj atyre që qëndrojnë.

Kur në vitin 1968, nga vjeshta, bashkë me tim atë vizitova për herë të parë teqenë bektashiane të Michiganit, nuk mund të më shkonte në mend se kjo vizitë do të ndryshonte jetën time.

shenjt të tyre e ndajnë me botën



Unë jam nga Michigani e në atë kohë merresha me studimin e turqishtes, sigurisht diçka kisha lexuar mbi bektashizmin, por për Shqipërinë dhe gjuhën e saj të mrekullueshme pak gjëra dija. Le pastaj për baba Rexhebin.

Na pritën mirë, na nxorën kafe e kakao, më kujtohen fotografite bardhë e zi të patriotëve shqiptarë të varura përgjatë mureve të sallonit. Ndërsa rufisnim kafënë, një baba tjetër, baba Bajrami i Gjakovës, i thotë diçka turqisht baba Rexhebit. Unë e kuptova dhe e pyeta babanë nëse dinte turqisht. Nuk kujtoja se dinte osmanishten, turqishten e re, persishten, arabishten, greqishten e italishten. Kur pashë erudicionin e tij, e ndjeva se do të kisha dëshirë të mësoja me të. Kështu rrodhi që një herë në javë, të shtunën e herë, të enjteve, të studionim bashkë, gjatë viteve 1970 e deri në 1995, vit kur babai ndërroi jetë.

Në teqe gjithë herët shkoja para dite. Në mëngjes herët babai bënte shëtitje të gjata. E kish nisur këtë punë kur ishte në kampet e përqendrimit në Itali, më 1944-1948. Nuk e di nëse ka mundur t'i vazhdojë këto shëtitje edhe kur ishte në

Egjipt ku ka qëndruar në teqenë Kaygusuz Abdall, në Mukatam, nga viti 1948-1952. Në Michigan teqeja është ndërtuar në një vend, që më parë ka qenë fermë e kur babai erdhi këtu i vazhdoi shëtitjet, qoftë për t'u ushtruar e ruajtur shëndetin, qoftë për të qenë i qetë dhe qoftë për t'u lutur. Baba Rexhebin unë e kam njohur nga moshë 60 deri në 94 vjeç. Edhe në këtë moshë ai shëtiste. Më ka qëlluar e jo rrallë, që kur veja për mësim e gjeja akoma duke shëtitur. Në kështu rastesh bashkohesha me të dhe mësimin e bënim duke ecur.

Më 1993 kam qenë në Shqipëri. Kam bujtur në teqenë e Zallit, afër Gjirokastrës, ku babai pat shërbyer si dervish për 20 vjet. Më pat thënë se Lazarati, banorët e të cilit prej vitesh kanë qenë bektashinj të devotshëm, nuk bëhet më shumë se 20 minuta nga teqeja. Por një mbrëmje ndërsa kthehesha nga Lazarati për në teqe dhe rruga më mori më shumë se 20 minuta nga "ato" të babait, e kuptova se sa të lehtë e ka të ecë, nëpër fushat e sheshta të Michiganit, kush është rritur në një vend shkëmbor e plot kodra. E kisha mësuar gjithashtu se babai kishte shumë mall për vendin e tij të lindjes.

Pas shëtitjeve ktheheshim në teqe e pinim kafënë. Nuk nguteshim kurrë. Shpesh kafënë na e bënte dervish Arshiu, sot baba Arshiu. Pastaj uleshim e studionim me orë të tëra. Babai ishte vërtetë njeri i mësuar. Më tregonte për bibliotekën që kishte pasur në teqen e Zallit me libra fetarë e studimorë në arabisht, persisht e osmanisht. Myrshidi i babait, apo siç i thuhet ndryshe, mësuesi shpirtëror i tij, baba Selim Elbasani, edhe ai ka qenë njeri i mësuar e një poet i madh. Babai më thoshte se kishte studiuar me vite me radhë, kurse Ragib Efendi Delvina e kishte përgatitur për të dhënë provimet në Gjirokastrë, provimet që jepeshin në publik. Veprën e tij kryesore "Misticizma Islame dhe Bektashizma" e ka punuar në Michigan në vitin 1972. Një pjesë të mirë të librit e ka shkruar duke u mbështetur në kujtesën e tij, duke e plotësuar pastaj me vepra që porosiste në Egjipt nëpërmjet një librashitësi.

Një punim tjetër me rendësi i babait, përkthimi i ("HADIKÀ Su'ada")i Fuzuli-ut, një libër ky që Naim Frashëri ka shfrytëzuar kur shkroi "Qerbëlanë" është një kryevepër e vërtetë. Sigurisht e shkruar në shekullin e 16-të në një osmanishte të rëndë, plotë persizma e arabizma baba Rexhebi e ka përkthyer në një shqipe të qartë e të fuqishme, madje edhe në poezi duke dëftuar kështu se edhe ai, sikundër mësuesi i tij ishte poet.

Si mësues babai ishte i ëmbël e plot kujdes. Kemi lexuar bashkë një mori vjershash fetare. Më pëlqente mbi të gjitha

kur ulej e mbështetej në ndenjësën e tij, nxirrte tespiet dhe e zhvillonte mësimin, duke treguar historira ato duke përdorur parabola: një mënyrë e hershme të mësuarit që unë mendoj se t'i ngulit apo shënime që përdoren në universitetet tona sot. Babai nuk e mbështeste mësimin në libra, a në pyetjet e mija: të mësonte me jetën e tij, mënyrën si të trajtonte njerëzit me besime e prejardhje të ndryshme, me kombësi e shtresa shoqërore të ndryshme. Kjo është mënyra bektashiane. Një arsimim i vërtetë që nuk mbetet tek pragu i klasës, po që hynë në zemër thellë. Gjatë mësimit nga ndonjë herë binte telefoni.

Dikush nga larg nga New York-u të themi, kërkonte një lutje për fëmijën apo shëndetin e familjes. Këto kërkesa babai i merrte seriozisht. Do të parapëlqente që këta njerëz t'i kishte aty, përpara tij e të vinte drejtpërdrejt duart e tij mbi kokat e tyre, për t'u lutur për ta pastaj. Po me që kjo nuk ishte e mundur, lutej nëpërmjet telefonit.

Në fund të mësimit e ndihmoja për të kryer letërkëmbimin. Njerëzit i shkruanin shpesh e ai sipas rastit u përgjigjej: shqip, anglisht, arabisht apo turqisht. Kishte raste kur njerëzit donin të këshilloheshin me të. Ai u përgjigjej me kujdes e maturi. Por në të shumtën, njerëzit vinin vetë në teqe, për ta parë e ndenjtur me të. Vinin për lloj-lloj arsyes për lutje, për t'u këshilluar për të zgjidhur mosmarrëveshjet, për t'i bërë shoqëri dhe shpesh për të gjetur një vend të qetë bektashian, një strehë që mundahej të qëndronte larg njerëzve e andralave të jetës amerikane. Kështu me kujtohet se si dikur një student shqiptaro-amerikan, erdhi në teqe për të përgatitur provimet në mjekësi.

Nga dreka vinte dervishi dhe diçka thoshte në shqip, sikur pëshpëriste: "Na thirri për të ngrënë". Ishte një gjë e vërtetë

Si mësues babai ishte i ëmbël e plot kujdes. Kemi lexuar bashkë një mori vjershash fetare. Më pëlqente mbi të gjitha kur ulej e mbështetej në ndenjësën e tij, nxirrte tespiet dhe e zhvillonte mësimin, duke treguar historira ato duke përdorur parabola: një mënyrë e hershme të mësuarit që unë mendoj se t'i ngulit apo shënime që përdoren në universitetet tona sot. Babai nuk e mbështeste mësimin në libra, a në pyetjet e mija: të mësonte me jetën e tij, mënyrën si të trajtonte njerëzit me besime e prejardhje të ndryshme, me kombësi e shtresa shoqërore të ndryshme. Kjo është mënyra bektashiane. Një arsimim i vërtetë që nuk mbetet tek pragu i klasës, po që hynë në zemër thellë. Gjatë mësimit nga ndonjë herë binte telefoni.

Dikush nga larg nga New York-u të themi, kërkonte një lutje për fëmijën apo shëndetin e familjes. Këto kërkesa babai i merrte seriozisht. Do të parapëlqente që këta njerëz t'i kishte aty, përpara tij e të vinte drejtpërdrejt duart e tij mbi kokat e tyre, për t'u lutur për ta pastaj. Po me që kjo nuk ishte e mundur, lutej nëpërmjet telefonit.

Dikush nga larg nga New York-u të themi, kërkonte një lutje për fëmijën apo shëndetin e familjes. Këto kërkesa babai i merrte seriozisht. Do të parapëlqente që këta njerëz t'i kishte aty, përpara tij e të vinte drejtpërdrejt duart e tij mbi kokat e tyre, për t'u lutur për ta pastaj. Po me që kjo nuk ishte e mundur, lutej nëpërmjet telefonit.

e këndshme të haje drekën me të. Zakonisht bëheshim nga tetë e deri në tetëmbëdhjetë vetë. Ai ulej në krye të tavolinës. Kur mori vesh se tim biri i pëlqente gjeli i detit, e porositi guzhinierin grek, Janin, që të enjteve për drekë të gatonte gjel deti. Kështu unë mund të merrja me vete një racion të mirë të këtij gjeli për djalin. Mua më pëlqenin dhe gjellët shqiptare që bektashinjtë shqiptarë sillnin me vehte, veçanërisht byreku apo petullat. Vetë babait i pëlqente shumë buka e misërt që baba Bajrami gatonte posaçërisht për të. Pas ngrënies babai vinte njëherë dorë mbi tjetrën mbi tavolinë e bekonte bukën, për të gjithë. Kur kam shkuar herën e parë, që ta kuptoja edhe unë, lutjen e tha në turqisht. Por dalëngadalë duke parë përparimet që bëja në gjuhën shqipe, e ktheu në shqip.

I lavdëruar qoftë Ay Zot i madh,

*Që na ushqen, na ujit aq sa na bën
ta falenderojmë.*

O Zot i ynë!

*Ti që bekon çdo gjë, bekoje edhe këtë sofër
dhe gjithë dashmirisht e vet.*

Jetën e gjatë, fatbardhësinë, lumturinë!

O Zot! Shtoje dhe kurrë mos e pakëso!

Drita e Profetit të math, hirësia

e të madhit Ali,

Pirit tonë Hynqar Haxhi Bektashit,

*Qoftë kudroherë prijësi dhe udhëheqësi
i ynë!*



Vini re! Kjo nuk është shqipja zyrtare, sepse babai ka qenë shtrënguar të largohet nga Shqipëria në vitin 1944 dhe në atë kohë gjuha zyrtare shqipe nuk ishte vendosur ende. I pëlqente të shkruante e të fliste në dialektin e tij, ose më mirë të themi gjirokastritçe, një shqipe që i pëlqeu aq shumë Ismail Kadaresë kur erdhi bashkë me të shoqen, për një vizitë në teqe. Më thotë mendja se shkrimtarit do t'i jenë kujtuar të afërmit e tij, pleq që moti në Gjirokastër. Me plakjen e babait, kur kopjoja ndonjë shkrim të tij dhe kisha nevojë për ndonjë ndihmë, u drejtohesha vetëm atyre shqiptarëve që e kishin shqipen gjuhë amtare. Por sa herë vija re se kërkonin ta ndryshonin si shumë dialektin e tij, nuk i pyesja më. Babai respektonte të gjitha dialektet e folura të shqipes. E donte shumë Fishtë. Mendoj se dhe gjuha e tij duhet të respektohet, sigurisht brenda një farë caku, dua të them aq sa njerëzit të mund ta kuptojnë. Prandaj dhe unë ndonjëherë, formën e vjetër "profit" e kam ndërruar e bëra "profet".

Zakonisht pasi kishim ngrënë drekën së bashku vrapoja për në punë. Por pas atij mësimi të mëngjesit si dhe ritit të përfunduar të drekës me baba Rexhebin ndihesha më e sigurt. Kisha qenë me babanë dhe e ndjeja veten më të qetë e të gatshëm, për të përballuar të gjitha hallet meskine të kësaj bote. Besoj se këtë ndikim e kanë ndier edhe shumë

të tjerë. Edhe z. Mërgim Korça ka shkruar për këtë dhe siç vëren gjithashtu ai, kjo është vërtetë diçka e vështirë për t'u përshkruar. Ngrohtësia e babait, dashamirësia e tij, ishte një bekim për të gjitha ata, që kishin fatin e mirë t'i qëndronin pranë.

Gjatë viteve të studimit në teqe duke marrë pjesë në komunitet e ditëve të shenjta të Novruzit dhe hashures munda të njoh shumë shqiptarë. Kështu pak e nga pak mësova historinë e këtij populli mësova se si trojet e një nga popujt më të hershëm të Ballkanit lakmoheshin nga grekët e nga sllavët. Edhe këtu baba Rexhebi më mësoi shumë gjëra. Por ai vetë kurrë nuk e gjykonte tjetrin nga kombësia. Ishte një patriot i madh një shqiptar që kish punuar e kish vuajtur thellë për popullin e tij. Por ishte dhe një amerikan krenar për atdheun e tij të dytë, për lirinë që ku vend ofronte.

Një ditë kur shkova si zakonisht për mësim, e gjeta babanë duke biseduar për të motrën zonjën Zejnepe Çuçin e me z. Xhevat Kalljaxhinë një shok i tij i vjetër nga Gjirokastra e që vinte në teqe për çdo verë. Ndërtimin në tokat e teqesë i "tyrbes së babait", apo i tyrbes bektashine ku ai do të vendosej pasi të kalonte nga jeta fizike, kishte filluar. Po bisedonin se çfarë duhej të thuhej në fet'hvanë, nëpër faqet e mureve të tyrbes. Z. Xhevat donte që të rregulloheshin e të viheshin në pah të gjitha ato që babai kishte bërë për

komunitetin. Por ky kundërshtonte. Në fund u muarën vesh të shkruhej sa më poshtë vijon:

*Ky mekam kaq i stolosur, i ndërtuar për babanë,
Ky simboli bektashizmit, që për jetë e shenjtëron,
Tregon dashurinë e madhe që njerëzit për të kanë
"Si dhe nderin e shquar, që myrshidi ynë gëzon.*

*Gjithë jetën e kushtoi pa u lodhur, pa kursim
Në shërbim të mëmëdheut, në shërbim të Perëndisë.
Për popullin fort punoi me gjithë zemër pa dallim,
U udhëhoq gjithmonë nga ndjenjat e mirësisë.*

*Kjo tyrbe përkujtimore teqenë përjetëson
Brez pas brezi nëpër mote falëtoje do qëndroj.
Dashamirët që e ndihmuan lartësisht po i nderon,
Edhe Pir Haxhi Bektashi gjithnjë do t'i bekojë.*

*Sa herë që e vizitoni këtë vend të shenjtëruar
Drejtoni mendimin tuaj me adhurim të vërtetë,
Mos kurseni Fatihanë për babanë jetë nderuar,
Që Zoti kurdoherë në zemër për jetë t'ju ketë.*

Në atë kohë, as që më shkante mendja se do të vinte dita kur babai, nuk do të ishte më në mes tonë. M'i kishte vënë emrin djalit, më kishte dhënë mësim tërë ato vite, madje edhe shtëpinë ma kishte bekuar. Më kujtohet mirë kur erdhi në atë shtëpi të vjetër që kisha mundur të blija. Qëndroi te dera e tha një lutje. Po bekimi i vërtetë që prania e tij brenda në shtëpinë time ku hëngri drekë e bëri muhabet me gjithë ne të tjerët. Marrë nga një këndvështrim më i gjerë, babai nuk bekonte vetëm shtëpi e familje. Prania e tij e gjatë në vendin tonë dhe varrimi i tij këtu në këtë truall, e kanë bërë të shenjtë këtë tokë. Dua të them se për Amerikën, baba Rexhebi ka qenë një bekim, kështu unë, edhe një herë i falënderoj shqiptarët që një tjetër shenjt të tyre e ndajnë me botën.



Poezi nga Sinan Elmazaj

Një dervish, që rri në portë!...

Në dasmat e mëdha,
Në fshatrat e mia,
Oshëtin si lum,
Gëzimi,
Mallakastriot,
Po mua nga dasmat,
Më vjen ndërmend,
Bardi dhe kënga”
“Një dervish, që, rri në portë!...”

Xha Damua, si bard,
Nis dhe këndon,
Dhe, ziejnë trapezat tej e tej,
Unë, dervishin,
Që rri në portë përfytyroj,
E nis të rreshtoj pyetjet.

Po ç'kumt ka dervishi,
Për dasmat tona?...
Dervishi me rrobën e bardhë,
Brezin jeshil!
Xha Danua,
Oh, xha Danua këngën,
Vazhdon ta këndojë,
Me zërin bilbil.

Dervishi uronte,
Për dasmën e madhe,
Të zotin e shtëpisë.
Të mbushej me gaz,
Kjo sofër bujare.
Të trashëgohej pas vitit,
Me qarje fëmijësh.

Unë besoj...

Po cilën lidhje kam me poezinë,
Dhe kam shkruar vargje aq të çiltër,
Unë besoj të mirën tek njeriu,
Unë besoj tek një yll i ndritur!

Unë besoj tek ai që thotë,
Ka një Zot mbi 'të dhe veç një Zot,
Ndaj si detarët Yllin Polar,
Thellësisht me zemër respektoj.

Thellësisht kur në gropë të zezë,
Një, që idhull quajta, më vërtiti,
I jam lutur Zotit të më nxjerrë,
Të shihja qoftë një dritë qiriri.

Që pastaj unë vetë ta ndizja,
Një qiri si dritë për njerëzinë,
Të të jem në paqe me ndërgegjen,
Të mos brengos më tej Bektash Velinë.

Se ia shkunda eshtrat disa herë,
Disa herë e vura në siklet,
Ai qe det' i madh i gjerë,
Dhe në heshtje paqësisht më flet.

O njeri, ti duaje këtë borë,
Jetën tënde dhe shtëpinë e Zotit,
Njerëzit janë vëllezër, pavarësisht,
Ngjyrës a fesë, anë e mbanë globit!

Këto motive në mendje më rrinë,
Dhe më ulin të shkruaj ndonjë varg,
Ja çfarë lidhje kam me poezinë,
Ja përse më fton kjo botë e bardhë!

Sikur, mes njerëzish!...

O miq, nga drurët frutorë ndjen,
Ma merr vetëm shega,
Pranverës, kur harlisen ngjyrat,
E kuqja dhe e gjelbra.

Kur dua të t'i them vajzës,
Ca fjalë dashurie,
Oh, shegë e kuqe rremba-rremba,
Një këngë ndër mend më bie.

Me frytin, që më pjek shega,
Në vjeshtë, atje në kopësht,
Ai bistak që mbanë kokrrën,
Më ngjanë sikur mbanë globin.

Bistakë të tjerë, në drurë të tjerë,
Plot fruta i ka shega,
Sikur nga lart skuq yllësia,
E praruara, Andromeda!

E çaj një fryt dhe hemisferat,
I ndanë paret i hollë,
Më tej, pas ndarjes shikoj shtetet,
Të gjitha tek ky glob.

Sikur mes njerëzish dashurinë,
Ta kishim si tek shega,
I plotfuqishmi do kishte zbuluar,
Besoj... dhe botë të tjera!

Në "Udhën e Qumështit"

Me "Udhën e Qumështit" kam fantazuar,
Në vegjëli, fantazoj edhe sot,
Dritën e bardhë nga kostelacioni i yjeve,
Doja ta shpërndaja mbi glob.

Të gjitha rrugët të çojnë në Romë,
Thonë, edhe në Stamboll, të tjerë,
Mua fantazia më çon larg,
Me "Udhën e "Mëndafshit" kinez.

Dy perandori i lidhi 'Egnatia',
Dhe më tej nëpër shkretëtirë,
Gjurmët e Aleksandrit të Madh,
Ua nxisnin njerëzve, guximin.

Tri perandori "Udha e Mëndafshit",
I lidh me konfiguracion të bukur,
Qytetet e mëdha, si yllësi në qiell,
Si galaktikat, kanë për t'u dukur.

"Udhe e Mëndafshit" si "Udha Egnatia",
Nga Vlora, nga erërat fillon,
Ejani miq e shihni si derdh,
Argjendin mbi 'të, hënë e plotë.

Udha e Qumështit dhe Udha e Mëndafshit,
Mes popujve, veç paqe sjellin,
Të afërta i bëjnë skajet e botës,
Me farërat e miqësisë që mbjellin.

Me Udhën e Qumështit kam fantazuar,
Galaktikat e mëdha, i ul në shesh,
Ndaj Vlorën time, Hirushen e Mesdheut,
Dua ta mbështjellë me mëndafsh kinez.

Mezi pres...

Ankaranë, Stambollin pas i lashë,
Sigurisht,
Një brengë më mundon.
Nuk shkova dot në Haxhi Bektash,
Nuk iu përula Pirit tonë.
Më duket sikur,
Të njëjtën brengë,
Kam me poetin Sergej Esenin,
Ai,
Asnjëherë nuk e pa Bosforin,
Unë,
Mezarin për Bektash Velinë!

Vlera e atij mezari,
Si një Taxh-Mahal,
Është e pa matë...
Të meditoj atje,
Me siguri qielli,
Të zbret në mendje,
Urtësi dhe paqe.
Sigurisht, unë brengën do t'a zbus,
Teksa Bosforit,
Endem ta shikoj.
Ja skela ku zbriste Naimi ynë,
Larg nga fshati,
Arnaut-Koj.



Baba Shefen me halle

Kur bisedova për herë të parë me baba Shefen? Ta them unë, të flasim xhanërisht biro. Seftë jam takuar me 'të në teqen e Sukës, në Përmet. Isha dervish mahere. Sapo kisha hedhur krahëve harkan e Haxhi Bektash Veliut. Në Sukë shkuam për ashure, se ashtu vinim asaj kohe ne dervishë e baballarë tek sho-shoqi, një herë në vit, në ditët e ashures. Po Suka ejvallah, kur vajçe unë ish plot me njerëz. M'u si blea në prill. Baba Kamber Muçua priste e përcillte njerëz nga dy krahët e Vjosës. Edhe nga krahu i Përmetit e Kolonjës edhe nga krahu i Labërisë. Në krah ' të baba Kamberit rrinte baba Shefqet Gllava. Por të gjithë i flisnin baba Shefja. Kur të shikonte në sy, duhet ta shihje në sy edhe ti se të merrte lugati ndryshe. Kur unë i putha duart dhe i thash se vija nga teqja e Golimbait të Vlorës, u çua në këmbë, ma mori kokën dhe ma vuri në gjoksin e tij. "Ti je dervish Arshiu?-më pyeti, dhe me sytë e ndritur më pyeti: "Kam pasur një natë në teqe në Koshtan Syrja Vasjarin dhe ai më ka rrëfyer për ty dhe familjen tënde. Je në udhën që duhet. Po deshe deri në fund Zotin dhe vatanin, do dalç faqebardhë. Ne kishim miqësi me bejlerët e Vasjarit, se helbete, bejlerët e kanë mbajtur lart emrin e Shqipërisë t'u haptë dera.! Lere

ç'thanë komunistët pastaj kur u vunë pushkën bejlerëve, por oxhaku s'bëhet buxhak biro!"

Gjatë bisedës së darkës, baba Kamberi, si zot shtëpie, e vuri baba Shefen në krahun e djathtë, pranë oxhakut. Baballarët e dervishët e tjerë rrinin pas tyre. Flitej me terbierte atë kohë. Duhet të dëgjoje më të shkuarin në moshë. Radha e muhabetit nuk vinte sipas vendit ku ishte ulur, po sipas udhës që mirrte biseda. Ah, të flas xhanërisht unë! Pas fjalëve të urta të baba Kamberit, i vinte radha gjithmonë baba Shefes. Ky, zërin nuk e ngrinte kurrë ejvallah, por fjala e tij të ngrinte peshë, m'u siç ngre peshë një burrë i fortë djalin e tij motak. Dinte të ngrinte lart fjala e tij, por dinte dh të ulte në tokë me ëmbëlsi. Jo të vërviste lart dhe të bije ti ku të doje. Eh baba Shefja me halle! Pas prillit të vitit 1939, matere kur iku nga Shqipëria Zogu me gjithë mëllënjën, unë vajç tek Sali Niazi Dedej. Erdhën breshkaxhinjtë biro, çfarë do bënim, duheshin edhe dyfekët, por edhe mentë. Sali Niazi Dedej më priti si djalin e tij, më pyeti për Dervishët e Vlorës dhe unë i rrëfeva. Kur erdhi puna tek dyfeku më tha si me mendje të thellë: "Po pritët tu vij italianin në derë të teqesë, e ka marrë lumi udhën tonë, udhën e Haxhi Bektash Veliut!"

E kuptova kërçast se çfarë më tha. Të nesërmen u nisa më këmbë njera në Ndroq. Aty i hipa një makine e vajç deri në Fier. Natën e shkova në teqenë e Mbyetit, ndërsa

efqeti

natën tjetër isha në Kuzum Baba të Vlorës. I dhashë karar se vatani duhej mbrojtur me dyfek ejvallah. Së bashku me Kujtim Koculin, Lahe Nuron, Ismail Golemin, Hysni Lepenicën dhe disa vlonjatë, formuam çetën nacionaliste dhe zumë nga lufta. Një dyfek këtu, një dyfek tjetër atje, ja kështu t'u haptë dera, avash-avash se breshkaxhinjtë ishin shumë e s'mateshim dot përballë me 'ta. Në motin 1940, ramë në një betejë me italianët në postën e Sevasterit. Vramë tri breshkaxhinj kur na erdhi haberi se po vinin treqind ushtarë me makina nga Vlora, drejt nesh. Ishte vjeshtë dhe Vjose ende nuk qe dendur mirë nga shirat. Vumë dyfekët në dy-tri kuaj se mos na njomeshin dhe vetë u kapëm fort me njeri-tjetrin e

dolëm në Kalivaç të Tepelenës. Aty më thotë Jaup Xhezo: "Dervish, jemi në duart tuaja nashti!". Qe errësirë, por unë e dija rrugën mirë dhe në mesnatë arritëm në teqenë e Koshtanit. I ramë portës me kujdes nga qentë. U dhe një dervish tek porta dhe unë i thashë: "Thuaj baba Shefes se ka ardhur dervish Arshiu i Golimbait me ca miq të tij!". Dervishi më përqafoi, na ftoi të futeshim, brenda dhe duke na rehatuar në një dhomë të vogël, pranë mejdanit ndezi zjarrin. Me buzën në gaz tha se nuk mund ta zgjonte baba Shefen

tani në mezine natës, se ishte teqja e Koshtanit ajo dhe se dera ishte e hapur për këdo, ditë e natë. Ne po thanim rrobat kur dera e dhomës u hap e m;u duk sikur hyri një dritë e madhe. Eh baba Shefua me halle! E kishte gjumin më të lehtë se penda e zogut. Na kish dëgjuar zërat, qe veshur dhe na përqafonte me radhë.

Ish nata e parë e muajit të bekuar të Ramazanit dhe në dritën e flakëve të vatrës, baba SZhefja, me duart në supet tona të lagura, na ngrohu me lutjen: "O Zoti im! Dhuro paqe dhe shpëtim për Muhamedin e familjen e tij! Nëse me faljen tënde në çdo natë të këtij muaji, do të shpëtosh një person nga dënimi, na bëj edhe ne pjesëtarë të tyre, na bëj prej njerëzve të mirë. Dhuro paqe dhe shlyeji mëkatet tona me mbarimin e hënës së këtij muaji, hiqi prej nesh detyrimet e mbetura së bashku me mbarimin e ditëve të këtij muaji. Na i fshij të gjitha fajet tona, na shpëto ndaj gjithë gabimeve. Vendos drejtësinë për ne dhe nëse largohemi nga udha jote të lutemi të na drejtosh nga e mira dhe nëse shejtani hun tek shpirtrat tanë, shpëtona o Zot prej tij. Na ndihmo të agjërojmë në ditët dhe netët e këtij muaji, na ndihmo të falim namaz të nënshtruar ndaj Teje, të përkushtuar vetëm e vetëm ndaj Teje. O Zoti im! Ndhmo këta djem në udhën që kanë nisur, në udhën e shpëtimit të vatanit!".

Na kishte hequr si me dorë krejt lodhjen e atyre ditëve. Na pyeti për të ngrënë, por meqë unë kisha harkan e Haxhi Bektashit, shokët panë nga unë. I thamë se do të hanim bashkë me dervishët e tjerë kur të vinte ora e sabahut. I ndritën sytë, se në teqen e Koshtanit s'kishte bërë vaki të prishej agjërimi i Ramazanit apo zija e matemit, or t'u haptë dera!

Ndejtënm tri dit e tri net në teqja pa dal përjashta. Forca të mëdha të breshkaxhinjve kërkonin në mallin e Kudhësit se nuk dinin që ne patëm kaluar Vjosën e qemë hedhur matanë. Por ne nuk dinim se edhe në xhadenë poshtë në Toç, ishte një postë tjetër e karabinerisë italiane dhe po të na zbulonin do të vinin me kuç e me maç të digjinin teqenë. Nga Koshtani u hodhën në Gllavë, dolëm në Bubës dhe prej andej shkuam në teqenë e Velabishtit në Berat. Atje u shpërndamë dhe fshehurazi zumë prap pozicionet tona në Qafën e Koshavicës. Ah, hiçgjë s'jemi Syrja Xhani! Asgjë veçse bizhdila në duar të fatit. Pas kalimit nga kjo botë e baba Bektashit, teqja e Golimbasis e di si mbeti? Si ajo shtëpia me halle që i vdes djali ivetëm. Baba Shefja dhe baba Ali Tomorri, nuk e di për çfarë pune, kishin shkuar në Tiranë tek dede Ali Rizai. Mbas disa ditësh ky më thërret në Tiranë e unë lash teqenë dhe për dy dit isha në Kryegjyshitë. Dede Aliu, zemërbardhë si fëmija, më tha se

duhet ta lija Golimbasin e të shkoja në Koshtantek baba Shefja. Se në teqenë e Golimbasis, dy-tri myhib ishin rreshtuar me nacionalçlirimtarët dhe këta pale ç'urdhër merrnin nga partia e tyre. Se unë, dihej ejvallah, isha i lidhur me rininë nacionaliste të Vlorës. Kur unë e pyeta dedenë nëse donte baba Shefja apo jo, që unë të shërbeja si dervish në Koshtan, ai qeshi dhe më kallzoi se vetë baba Shefja kishte kërkuar të veja atje. Mora bekimin e dede Aliut dhe të nesërmen, menjëherë u nisa për në Koshtan. Rrugën e bëra më të shumtën me këmbë dhe më të paktën me automobil. Ashu ishte koha maherë or bir! As telefona s'kish, as dreqi me brirë. Po natën e dytë të udhëtimit

aty në krye të udhës që zbret për në teqe, pashë në dritë të hënës një harka të bardhë, mbështetur tek mëni i vjetër dhe i madh. M'u duk se më bënë sytë nga lodhja. Po ja, qeç gabuar. Tek vështroja si mëdysh dëgjova zërin e bekuar të dervish Muharremit si me këngë:

“Ç'i njihje udhët e Krasit/
o dervish i Golimbasit!”

Maherë e kuptova se nuk isha në gjumë. U përqaftova me dervishin e ndërsa po më hapte derën e teqesë më tha se e kishte nxjerrë aty, baba Shefja duke i thënë: “Pa dil atje tek mëni se ma heq engjëlli që do kemi një mik sonte!”. Ky është bektashizmi o tu haptë dera! E nxjerrë mrekullinë nga dheu dhe e ngre havadan në qiell ta shohin të gjithë. Ky ishte baba Shefja. E di ti histoprinë e dervish Abdyl Meminit? Ma ka rrëfyer baba Rexhebi, i qofsha falë. Abdyl Memini ish dervish i Ballëm Sulltanit. Ky e dërgoi në vendin e bekuar, në Qerbela, aty ku u vranë për pikën e ujit Abaz Aliu dhe Imam Hyseni, drita e syve tanë. Dikur, kur mbreti Sulejman i Turqisë do shkonte për ziares në Qerbela, u takua me Ballëm Sulltanin. Ky i këndoi duanë e udhës dhe i dha një shkop të gdhendur. E porositi mbretin që kur të shkonte tek tyrbja e Imam Hysenit, të takohej me dervish Abdyl Muminin që shërbente aty dhe ti jepte këtë shkop si dhuratë. Mbreti e takoi dervishin dhe u mahnit nga njohuritë dhe pastërtia shpirtërore e tij. Tek ikte, i tha: “Çfarë të mire mund të bëj për ty?”. Dervishi, megjithëse jetonte në një çadër sa për dy vetë, tha se ishte i kënaqur nga kjo botë dhe nuk donte asgjë, por nëse kishte mundësi të ndihmonte popullin dhe besimtarët që vinin për zijaresh, duke çuar aty ujin e lumit të Euftratit. Mbreti Sulejman nuk ja prishte dot

dervishit dhe filloi nga punimet, por qe shumë e vështirë. Atëherë, kur pa vështirësitë, ky shkoi përsëri tek dervish Abdyl Muminin dhe i kërkoi vetëm një dua që uji të mos vonohej. Ah t'u haptë dera! Kush kërkon duanë e dervishit është gjithmonë i fituar. Lumi Euftrat vaditi tokën e Qerbelasë që derdhte lot dhe mbante zi akoma për Imam Hysen shenjtorin.

...Ndenja plot dy vjet me baba Shefen në teqe të Koshtanit. Baba Shefja qe shpirt njeriu, por kohërat ishin të liga ejvallah. U ndanë vëllezëria e shqiptarëve më dy krahë dhe o burra kush ti bënte sho-shoqit pas krahëve. Ca donin shqiponjën e Skënderbeut, ca këndonin: “Bijte e Stalinit jemi ne!”. Baba Fejzo, deri maherë e kishte dashur me kokë

baba Shefen. Më 1943, në Shëndre, erdhi në teqenë e Koshtanit me një dhjetë apo dymbëdhjetë partizanë dhe qëndroi më shumë se një javë në teqe. Gjithë ditën e molloiste baba Shefen se komunizmi do e nxirrte vatanin tonë në drejtë, do e bënte kështu e do e bënte ashtu. Por baba Shefja ishte dhe i mençur dhe i urtë. Mbaj mend që i thoshte në çdo fund muhabeti: “Ne jemi dervishë të Haxhi Bektashit. Për të luftuar armikun jam dakord. Ama për të luftuar njeri-tjetrin se do ti komunizmin, s'jam dakord. Janë të mallkuar nga Zoti dhe nga Haxhi Bektash Veliu, ata shqiptarë që shkojnë e vrasin njeri-tjetrin për mustaqet e Stalinit!”.

Ditën që do të ikte baba Fejzo nga teqeja tok me partizanët, zuri një shi, të thuaç ti se u përmbys dynjaja.



Baba Shefja, me shpirtin e pastër, iu lut të rrinin edhe atë ditë, por inati i baba Fejzos nuk mbahej dot. Ish si ai kali në tatëpjetë e pa kapistër. Ai nuk e kishte futur baba Shefqetin në kllapat e nacionalçlirimtares dhe kjo i prishte shumë punë, ndaj edhe kur fliste atë saba, i mbante

sytë në dhetë. U dha urdhër atyre partizanëve të vegjël nga mosha të ishin gati, duke u folur gjithë inat. Pa takuar asnjërin prej nesh, iu drejtua baba Shefes plot zemërim: “Do më shohësh se kush jam!”.

Unë e pata fshehur nën harka një pushkë gjermane që ma kishte falur baba Shefja dhe ndiqja me vëmendje gjithçka. Kisha frikë se mos më qëllonin babanë, dritën e syve të mi. Çfarë nuk mund të mos prisje nga ata 16 vjeçarë që kishin harruar kush i kishte pjellë dhe thoshnin jemi bijtë e Stalinit! Kur baba Fejzo tha se ‘do të më shohësh se kush jam’, baba Shefja uli kokën dhe sikur i ra pika. Pastaj iu afrua partizanëve dhe u tha me gjysmë zëri: “Më vjen keq për ju biro!”. Njeri prej tyre, duke e parë babanë si reaksionar të rrezikshëm dhe duke kujtuar se atij i vinte keq se do lageshin në shi, iu kthye baba Shefes duke i thënë se rrobat do u lageshin po barutin e pushkës e kishin të thatë. Baba Shefja heshti një çast dhe u tha dy fjalë të mëdha: “Barutin e pushkëve mund ta ruani të thatë, por është njomur e bërë qullë baruti i shpitrave or djemtë e babait. Mos e vinin komunizmin mbi vatanin se Ai lart sheh çdo gjë!”.

Po atë natë, në Iliar ndërsa shkonin në Tepelenë, një rrufe nga qielli kishte vrarë një partizan të baba Fejzos. Kishte shpirt të pastër baba Shefja or t’u mbarofshin të ligat. Hakën e tij, merrnin të tjerët. Në ditët e fundit të tetorit 1944, na erdhi haberi nga dervish Rexhebi në teqen e Koshtanit që baba Shefja duhej të shkonte urgjent për në teqenë e Lazaratit. Derëbardhi baba u mejtua tërë natën dhe në mëngjes më thirri mua në kafeoxhak. Me sa duket, ai e kishte kuptuar thirrjen e dervish Rexhebit, si një thirrje për tu bashkuar përfundimisht me fatin e forcave nacionaliste. Nga mënyra se si më fliste, e kuptova se baba Shefja qe mejtuar e s’kish vënë gjumë në sy gjithë natën. Por edhe udhëtimi i tij për në Lazarat qe shumë i rrezikshëm, pasi dihej që fshati ishte fole e Ballit Kombëtar dhe mund të kishte probleme të nesërmen, ejvallah. Prandaj baba Shefja kishte shkruar një letër për dervish Rexhebin dhe pasi më porositi për udhë, më bëri duanë që duhej. Ja ashtu, udhë e pa udhë, me pushkën e vjetër gjermane nën harka, në mbrëmje vonë shkova në Lazarat, në shtëpinë e Maliq Bashës, se aty ishte vendosur dervish Rexhebi. Ky, kur më pa, më

përqafoi dhe derdhi lot. E kuptoi menjëherë se baba Shefja nuk donte të linte vatanin. Nxorra letrën nga xhepi i fshehtë i hajdaries dhe ja dhashë. E lexoi me një frymë. I tha Maliq Bashës të më gjente një vend për të fletur dhe pasi hëngrëm darkë më tha se nuk do nisesha nesër pa marrë një letër të shkruar me dorën e tij për baba Shefën. Unë isha shumë i lodhur. Sa vura kokën në jastëk, kërçast më zuri gjumi. Të nesërmen dervish Rexhebi më erdhi tek jataku. Hop ja bëra dhe në këmbë. Isha djalë i ri ejvallah. Të merrja gjak në vetull. Se mos vetëm unë. Kështu ishin gjithë djemtë e Vlorës. Na kish formuar stralli. Dervishi më dha një çantë me bukë e ushqime ta kisha me vete. Pastaj nxori letrën nga xhepi hajdaries dhe duke ma dhënë, me sytë e ngulur diku nga teqja e Melanit, në Nepravishtë, më tha: “Baba Shefja ka rënë nga qielli. Nuk i ka mësuar djallëzitë e komunistëve. Ishalla Zoti e mbron dhe e nxjerrë pa siklete nga kjo mortje që po vjen!”.

U nisa nga kisha ardhur. Shkrepave e shkrepave se nuk doja të më pikasin komunistët. Më kishin vënë në nishan që kur varrosëm eshtrat e Hysni Lepenicës dhe trimave të tjerë në Teqen e Zallit në Gjirokastër, në shtatorin e vitit 1943. Kur trokita në portën e teqesë, kishte kaluar mesnata. Dëgjova hapa të ngadalta. Nuk ishte dervish Muharremi, se ky vinte fët e fët. E kuptova që ishte baba Shefja. Më përqafoi, i tregova bisedën dhe nxorra letrën e dervish Rexhebit. Mu dhimbs kur e shihja të lexonte në dritën e kandilit. Gati sa nuk qava, ejvallah. Se kur bie loti nga syri i myrshidit, domosdo që nxënësi i tij, bëhet si deti me dallgë në dhjetor. Dervish Rexhebi i kishte lënë të ‘mirëmbeçin’.

Ja kështu or t’u harrofshin të ligat e kësaj bote! Një vit më vonë unë u largova nga Shqipëria dhe bashkë me pushkën e vjetër gjermane, baba Shefja më dha bekimin dhe disa monedha floriri t’i kisha për ditë të ligë. Lajmin për vrasjen e tij, e mora në Greqi, në kampin e emigrantëve politikë në Llavrios. Erdhi një ditë nga Athina dhe na takoi Profesor Luan Gashi. Ishin shumë djem të Ballit Kombëtar që përgatiteshin në emigracion në Amerikë. Në fund të bisedës na tha për gjëmat që ndodhnin në Shqipëri. Pa nga unë dhe më tha se komunistët kishin pushkatuar baba Shefqet Gllavën. S’i mbajta lotët. U çkreha së qari. U thash miqve të mi se baba Shefja nuk i vjen më Labërisë, këtej e matëjme Vjosës.

*** Biseda e zhvilluar nga S. Xhelaj në teqen bektashiane në Detroid-Miçigan të SHBA, më 10 Nëntor 2016**

Etyd dhimbjeje

Kur ra mbrëmja, trimi ynë mblodhi besnikët e vet dhe, pas lutjes drejtuar Allahut, tha:

Unë ju quaj miq besnikë dhe familjen time më të mirë. Allahu ju bekoftë dhe pastë mëshirë për ju. Shikojeni qiellin dhe sipas yjeve orientohuni në errësirë. Secili prej jush, le të marrë për dore një nga njerëzit e familjes sime dhe të largohet nëpër terr. Më lini me këtë popull, përderisa unë u duhem atyre. Vëllezërit dhe fëmijët e Imam Hysenit, fëmijët e Abdullah ibn Xhafarit thanë: Përse të veprojmë kështu, që pastaj të jetojmë pa Ju, mos e dhëntë Allahu një ditë të tillë!

Këto fjalë i tha i pari Abaz ibn Aliu dhe gjithë të tjerët e mbështetën. Atëherë Imami vështroi fëmijët e Myslim ibn Ajkalit dhe tha: Vdekja e atit tuaj, Myslimit, mjafton për familjen tuaj. Largohuni dhe unë nuk do ju pengoj. Sipas një version tjetër, në këtë kohë, e gjithë familja dhe vëllazëria nisë të flasin dhe thanë:

O, bir i Profetit! Çfarë do të thonë njerëzit, po ne çfarë do t'u themi atyre, t'u themi që e braktisëm udhëheqësin tonë, djalin e vajzës së Profetit dhe nuk luftuam me shpatat dhe heshtat tona krahas tij? Jo, betohemi për Allahun se nuk do t'ju braktisim dhe do t'ju mbrojmë me jetën tonë, derisa të vdesim krahas Jush. Zoti do të na e bëjë jetën të bukur vetëm nëse jemi pas Jush.

Pas kësaj, Myslim ibn Asuxhe u ngrit e tha: - Ne t'ju lemë vetëm mes këtyre armiqve, të cilët Ju kanë rrethuar? Jo, betohem për Zotin se Ai nuk do të më shohë të tillë, unë do të luftoj në një mënyrë që heshta dhe shpata ime të thyhen mbi gjoksin e tyre

dhe, përderisa të jem në gjendje të mbaj shpatën në dorë, do të di si të mbrohem nga goditjet e armikut dhe, nëse nuk do të më mbetet asnjë armë tjetër, do të qëlloj kundër tyre me gurë derisa të shuhem për Ju.

Pastaj Samid ibn Abdullah Hanifi u ngrit e tha: - Jo, betohem për Zotin se nuk do të lemë kurrë vetëm, asnjëherë, që Zoti ta mësonte se ne ia dëgjuam fjalët Profetit të tij (shpirti iu prehtë në paqe dhe qetësi). Nëse do të më vrisnin dhe më pas do të më ngjallnin sërish, pasi të më digjnin dhe të ma shpërndanin hirin tim dhe kjo të ndodhte shtatëdhjetë herë, unë prapëseprapë nuk do t'ju braktisja, kurse këtu vdekja vjen vetëm një herë dhe pas kësaj ia mbërrin lumturia e pafundme. Pas tij, Zohejr ibn Hejni u ngrit e tha: - Betohem për Allahun o bir i Profetit! Unë dëshiroj të vdes një mijë herë vetëm që Ju dhe familja Juaj të mbeteshit gjallë! Besnikët e tjerë të Imamit thanë fjalë të ngjashme:

Ne do të sakrifikojmë jetën tonë për hir Tuaj. Ne do t'ju mbrojmë me duart dhe trupat tanë, do të vdesim bri Jush, duke e mbajtur fjalën e dhënë para Zotit dhe duke e përm-bushur detyrën tonë. Në këtë kohë, Muhamed ibn Beshirit i njoftuan se i kishin arrestuar të birin, në kufi të Reas. Ai tha: Unë e shoh këtë si vullnet të Zotit, betohem me jetën time se nuk do doja që ta zinin rob, sa të isha gjallë.

Imam Hyseni, tek e dëgjoi, i tha:

Të mëshiroftë Allahu, ti je i lirë nga çdo besë, ik dhe çliroje birin tënd.

Muhamed ibn Bashiri iu përgjigj:

Le të më shqyejnë kafshët e egra dhe le të më hanë, por kurrë nuk do t'ju braktis. Imami iu përgjigj:

Atëherë jepja këto sende tët biri, që ta çlirojë ai të vëllanë.

Dhe ai ia dha djalit tjetër sendet që kushtonin njëmijë dinarë. Atë natë para Ashures, të gjithë ishin zënë me lutjet ndaj Allahut, disa falnin namazin, disa duke ndenjur, disa duke qëndruar në këmbë, të gjithë, pa përjashtim, pësh-përitnin lutjet e fesë. Atëherë tridhjetë e dy ushtarë nga ushtria e Omar ibn Saadit u bashkuan me Imamin që të luteshin edhe ata, ai u lut për një kohë shumë të gjatë.

Ibn Abad Rabe, në kreun e katërt të librit të tij Alaagd Algrid, shkruan: "E pyetën Ali ibn Hysenin – Imam Saxhazin, - Përse ati juaj ka pak fëmijë – ai u përgjigj – dhe kaq sa janë është për t'u habitur, përderisa ai në njëzetë e katër orë lutet njëmijë herë dhe nuk i del koha që të merret me gratë".

Mëngjesin e kësaj dite që do të mbetet në historinë njerëzore i papërsëritshëm, Imami urdhëroi që të ngrinin tendën, ku kishin vendosur një enë me uthull dhe nur për pastri-min e flokëve. Imami hyri brenda



dhe u mor me pastrimin. Barir ibn Hozejri dhe Abdyl Ansari, një nga shoqëruesit e Imamit, qëndronin para tendës, ku po lutej Imami. Gjatë kësaj kohe Bariri po përpiquej të bënte shaka me Abdyl al Rahmanin. Ky trim i tha: Ti po qesh? Mos vallë kjo është kohë për të bërë shaka? Bariri i tha si përgjigje: Të afërmit e mi e dinë se unë as në rini dhe as në pleqëri nuk kam bërë shaka, por tani jam i gëzuar, sepse shumë shpejt do të biem dëshmorë, ndaj dhe gëzohem e bëj shaka. Betohem për Allahun se shumë shpejt do të ndeshemi me armikun, disa orë do të luftojmë dhe më pas do të bashkohemi me hyriet e xhenetit.

Nga ana tjetër, ushtria e Omar ibn Saadit po përgatitej për luftë. Imam Hyseni dërgoi Baririn që edhe një herë të shmangte luftën dhe u foli atyre për faktet. Por fjalët nuk e ndihmuan atë. Atëherë Imami u ngjiti mbi kalin e tij dhe i kërkoi ushtrisë armike të heshtte. Pas lutjes drejtuar Allahut dhe Profetit, ai tha:

O njerëz, është gjynah që të kërkoni vdekje dhe varfëri për ju. Kur të gjendur në dhembje, të hutuar dhe në skamje, kërkuat ndihmën tonë, ju dërguat letra, ku u betuat se shpatat tuaja do të përdoren për të na ndihmuar dhe kundër armikut tonë, kurse tani shpatat tuaja janë drejtuar kundër nesh. Ju u bashkuat me armikun kundër miqve tuaj, pa marrë parasysh se ata nuk ju kanë paraqitur dëshmi për padrejtësinë e gjykimit tonë. Gjynah për ju! Përse kur ish paqe dhe shpatat nuk i mbanit në duar, nuk na e kthyet shpinën? Tani, si ato fluturat digjeni ndaj zjarrit të gjynahut. Si nuk ju vjen turp? Mjerim për ju o, robër të së keqes dhe shkatërrues të unitetit të popullit, ju i shtrembëroni fjalët e Zotit dhe të librave të Tij, ju i jeni nënshtruar shejtanit, e shuat dritën e sheriatit dhe traditat e Profetit. Ju u ndihmoni të tillë njerëzve dhe hiqni dorë prej nesh? Po, betohem

për Allahun se dinakëria dhe gënjeshtria rrjedhin në gjakun tuaj prej kohësh. Ju jeni frytet e një druri, i cili është për të zotin e tij hidhërim dhe fatkeqësi, kurse për pushtuesin një ushqim i shijshëm. Mësojeni, pra, se ky i pandershëm më ka lënë vetëm dy zgjedhje: luftë ose nënshtrim, por nënshtrimi nuk është për ne. Allahu dhe Profeti i tij dhe besimtarët nuk e pranojnë të keqen dhe nuk i nënshtrohen padrejtësisë. Njerëzit me erz nuk na e lejojnë që ne të parapëlqejmë nënshtrimin e përbuzur në vend të një vdekjeje të denjë. Mësojeni, pra, se unë, pavarësisht nga sasia e pakët e të afërmeve dhe besnikëve të mi, do të luftoj me ju.


– Pas kësaj, Imami e vazhdoi ligjërimin e tij me vargjet e Orve ibn Masik Moradisë – Nëse ne do ta mundim armikun, kjo nuk është për t'u habitur, sepse ne gjithmonë kemi fituar, por, nëse do të pësojmë humbje, megjithatë ne do të fitojmë, se ne jemi të pathyeshëm përderisa humbëm jo prej tmerrit, por thjesht sepse vdekja erdhi drejt nesh dhe se erdhi koha që të tjerët të fitojnë.

Nëse vdekja nuk vjen për disa, atëherë ajo vjen për të tjerët, në këtë mënyrë vdekja erdhi për të parët e mi, siç erdhi dhe për të tjerët. Nëse mbretëritë e qiejve janë të përjetshme, atëherë dhe ne jemi të përjetshëm dhe nëse të urtët tanë të respektuar do të jenë të përjetshëm, atëherë dhe ne do të jemi. Atëherë, u thoni armiqve tanë, se ajo që do të ndodhë me ne, do të ndodhë edhe me ta.

– Pastaj vazhdoi: – Betohem për Allahun se, pas vrasjes sonë, ju nuk do të jetoni gjatë, aq sa një këmbësor mund të kalërojë mbi kalë dhe do të jetë i humbur dhe i çoroditur. Për këtë më ka folur gjyshi im, Profeti dhe ati im. Në punët tuaja, këshillohuni me miqtë tuaj që të mos gaboheni dhe të mësoni të vërtetën. Atëherë mund të më sulmoni dhe të më vrisni, përderisa unë mbështetem në Zotin tim dhe tuajin, të atij Zoti që vendos fatin e të gjithëve dhe që jam i bindur se do të bëjë gjënë e duhur. O Zot, merrua atyre shiun dhe dërgoju thatësirën, siç ndodhi në kohën e Jusufit dhe caktohu atyre një qeveritar që t'u shkaktojë dhembje dhe mundime, përderisa ata nuk pranuan të na ndihmojnë dhe na mashtruan. Ti je Zoti ynë, ne të besojmë dhe të drejtohem, dhe sërish kthehemi po tek ty. Pas kësaj, Imami zbriti nga kali, kërkoi kalin e Profetit, me emrin Mortaxhes, dhe thërriti shoqëruesit e tij që të gatiteshin për luftë.

Imam Bageri (shpirti iu prehtë në paqe) rrëfen se Imami kish vetëm dyzetë e nëntë kalorës dhe njëqind këmbësorë.

Përgatiti: Enea Muhameti



RUBAIRA

nga baba Tahir Hamedani

**Kryegjyshi Botëror Bektashian
Hirësia e Tij
Haxhi Dede Edmond Brahimaj**

Në emër të Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Falënderimet dhe lavdërimet janë vetëm për Allahun e Lartë, i cili së toku me Muhamedin, paqja dhe shpëtimi qoftë mbi Të, dhuroi për ne mirësinë më të madhe, atë mirësi që nuk e patën popujt e shkuar, në shekujt e shkuar. Falënderimet i takojnë familjes së Ehli-Bejtit, e cila sot e kësaj dite merr dritë nga drita hyjnore dhe ua përcjell miliona besimtarëve në botë, duke u ngjallur besimin e thellë dhe duke u shumëfishuar shpresat e tyre.

Fort i nderuar miku i vyer i bibliotekës bektashiane!

Doja t'u merrja pak çaste nga koha juaj e çmuar, pikërisht ndërsa shfletoja tufën me poezi mistike të poetit persian të shekullit të dhjetë, baba Tahir Hamedanit. Midis letërsisë botërore dhe tarikatit bektashian, ka një lidhje të brendshme, gati unikale, e cila ndonëse në pamje të parë nuk zbulohet lehtë, por pas hulumtimeve fatsjellëse të zbulon një mozaik të mrekulluëshëm. Është e njohur tanimë mendimi, se letërsia, qysh se ka nisur të shkruhet, ka patur si mision të parë frymëzimin e njeriut për një botë më të mirë, për një jetë sa më të denjë shpirtërore. Brenda universit të saj, janë lindur, rritur e zhvilluar modele të tëra të ngadhënjimit të dritës së arsyes, mbi verbërinë e padijes, të fuqisë së pa skaj të shpirtit, ndaj kornizave që na afron bota materiale.

Edhe tarikati bektashian, në tetë shekuj të lindjes dhe zhvillimit të tij, ka mundur të përmbushë përmes dhimbjeve dhe sakrificave sublime, misionin e vet madhështor, atë të pastrimit të shpirtave, duke besuar deri në fund Krijuesin dhe duke u kujdesur që çdo minutë në jetën e besimtarit, të jetë e vlershme dhe shpresëdhënëse deri në çastin e mbramë të tij. Një përjasje e tillë midis letërsisë botërore në shekuj dhe tarikatit të hershëm bektashian që ne i përkasim, na bën sigurisht më të lumtur, ne klerikëve, besimtarëve, por edhe armatën disa milionëshe të dashamirësve në gjithë botën.

Sigurisht përpara se të shihte dritën e diellit, bektashizmit i ishin çelur udhët e depërtimit të tij shpirtëror. Letërsia mistike me margaritarët e saj, me emrat që ende sot i bëjnë nder mendimit estetik dhe filozofik botëror, kishte fituar territore shpirtërore të pakrahasuar. Në mënyrë të veçantë letërsia mistike persiane, me atë harmoni të brendshme plot ritme po lulëzonte dhe me të drejtë studiuesi i njohur francez, Grishman thotë se “bota e sotme letraro-mistike, duhet t’ia dijë për nder mistikëve-persë të cilët, për gati shtatë shekuj sendërtuan doktrinat më tërheqëse filozofike të kohës.”

Vetëm brenda këtyre prurjeve mund të shihet me seriozitetin dhe vullnetin e duhur filozofik, vepra e baba Tahir Hamedanit. I lindur në fundshekullin e nëntë në qytetin plot shkëlqim të dikurshëm të Hamedanit, ky mistik i madh njohu lulëzimin e periudhës së perandorisë Akamenide, ku sheshet mëngjeseve zbukuroheshin prej veprave antike dhe mbrëmjeve, të mëdhenj të vegjël mblidheshin për të dëgjuar nefeset e baba Sulltanit, baba

Hanxharit, baba Nezirit si edhe qindra dervishëve kalenderë. Mes kësaj jete aq të pasur shpirtërore, baba Tahiri në rininë e tij, më së paku meditonte brenda heshtjes proverbiale, duke dashur që të kuptonte nga e merrnin frymëzimin ata vargje të çuditshëm. Ishte tepër i ri, kur e pati kuptuar lojën qesharake dhe të përkohshme të kësaj jete dhe vërtetësinë e botës së përtejme.

Pikërisht i ndikuar nga fryma mistike e paraardhësve të vet, nga shoqëria dhe zhvillimet e kohës që jetonte, por i prirur kurdoherë ndaj një jete sa më të pasur dhe të pastër shpirtërore, ky djalosh meditativ i Hamedanit, iu vu studimit në thellësi të asaj përvoje aq komplekse që gjallonte haptas në qytet. Rrëfejnë se mbrëmjeve të vona në kthinën e vetmuar, ku erërat e shoqëronin tërë natën, pranë dritës së qiririt ai lutej dhe meditonte deri në ag. Ishin kalimtarët ata që i jepnin ndonjë kafshatë nga buka e tyre dhe mahniteshin me harkanë e tij të andruar. Vite më pas, për shkak të varfërisë të skajshme dhe harkasë së grisur, baba Tahirit, pranë emrit, i shtuan mbiemrin Orian (përkthyer "i zhveshur" në shqipen e sotme) dhe e thirrën kështu deri në çastin e fundit në këtë botë.

Janë disa burime dokumentare të shekujve dymbëdhjetë e më vonë, të cilët e ngrenë në piadestal talentin mistiko-filozofik të baba Tahirit, sikundër flasin edhe për prirjet e tij artistike. Nefeset e tij, përveç aromës të maleve e blirëve, jetuan gjatë sepse mbartën ndjenjat më të kulluara të dashurisë ndaj Zotit të Lartë, suallën mendimet universale të dervishit kalender, kujtuan dhimbjet e kurbetit apo pikëllimin e heshtur për njerëzit më të afërt. Sa hyjnorë aq edhe të prekshëm, vargjet e nefeseve të baba Tahir Hamedanit, u përhapën asaj kohe anekënd viseve të Azisë, madje sot në takime të traditës apo festivale të panumërt të mistikës, këngët e tij na vijnë përmes drithërimës të sazeve apo fyejve të hershëm. Pavarësisht se Omar Khajami erdhi në këtë botë një shekull pas baba Tahirit, shpesh herë vlerat mistiko-filozofike të këtyre dy kolosëve të literaturës vlerësohen si të pandashme.

Siç thamë më lart, letërsia bektashiane ka pirë ujë në këta burime të mrekullueshëm, duke mbujtur brenda vetes atë urtësi dhe mençuri popullore, ku mitet dhe të vërtetat pleksen në rrjedhat e kohës, në përpjekje për të lartësuar shpirtat njerëzorë. Veçanërisht nefeset e shkruara prej dervishëve dhe baballarëve, transmetuan ndijime mistike dhe kulturore të qarta, në krye të të cilave qëndronte ideja e famshme e Haxhi Bektash Veliut, i cili porosiste: "O dervish! Dije se veliu i Allahut është Nuhu i kohës së vet. Ndihma e tij është anija që i shpëton robërit e Allahut prej fatkeqësive të përmytjes. Në përmytjen e ujit, mund edhe të shpëtosh se ka lidhje me trupin e fuqishëm. Por përmytja prej padijes s'ka shpëtim. Kush mbytet në padije, nuk shpëton dot gjer në përjetësi."

Në këtë kontekst edhe dervishët dhe baballarët bektashianë të trevave shqiptarë kanë dhënë kontributin

Pikërisht i ndikuar nga fryma mistike e paraardhësve të vet, nga shoqëria dhe zhvillimet e kohës që jetonte, por i prirur kurdoherë ndaj një jete sa më të pasur dhe të pastër shpirtërore, ky djalosh meditativ i Hamedanit, iu vu studimit në thellësi të asaj përvoje aq komplekse që gjallonte haptas në qytet. Rrëfejnë se mbrëmjeve të vona në kthinën e vetmuar, ku erërat e shoqëronin tërë natën, pranë dritës së qiririt ai lutej dhe meditonte deri në ag. Ishin kalimtarët ata që i jepnin ndonjë kafshatë nga buka e tyre dhe mahniteshin me harkanë e tij të andruar. Vite më pas, për shkak të varfërisë të skajshme dhe harkasë së grisur, baba Tahirit, pranë emrit, i shtuan mbiemrin Orian (përkthyer "i zhveshur" në shqipen e sotme) dhe e thirrën kështu deri në çastin e fundit në këtë botë.

e tyre të çmuar. Ndonëse disa e tyre nuk kanë shkruar në gjuhën shqipe, ndihet sidoqoftë në krijimtarinë bektashiane jo vetëm identiteti shqiptar, por edhe fryma atdhetare e teqeve, të cilat misionin e tyre fetar e konceptuan dhe zhvilluan kurdoherë brenda devizës së bekuar se "Pa atdhe nuk ka fe"

Mrekullisht ne mund të shijojmë dhe të meditojmë sot, rreth nefeseve të shkruara nga: baba Adem Vexhiu nga Kosova, baba Meleq Shëmbërdhenji, Sali Niazi Dedei, baba Ahmet Turani, baba Siri Gjirokastra, baba Ibrahim Qesaraka, baba Ali Tomori, baba Sali Matohasanaj etj, të cilët kanë pasuruar jo thjesht letërsinë tonë, por krejt universin botëror të letrave bektashiane.


Vendi ku prehet baba Tahiri, në Hamedanin e sotëm, është shndërruar në stacion pelegrinazhi të pafund, ku mijrat e pelegrinëve luten pa reshtur dhe meditojnë në heshtje. Ata shkojnë atje nga gjithë bota dhe përulen shpresëplotë tek mezari, sepse vepra dhe jeta e baba Tahirit, shihen kurdoherë përmes një uniteti të mrekullueshëm të mendimit dhe vlerave të përjetshme shpirtërore.

Selia e Shenjtë Bektashiane këtu në Shqipëri, me botimin e këtij libri, me shpërndarjen e tij në bibliotekat e teqeve anekënd botës, në të vërtetë i bashkohet vargut pafund të këtyre pelegrinëve, me respektin e thellë e të përjetshëm ndaj mistikëve tanë.

Lexim të këndshëm vëllezër të mi!

KOSHTANI TEKKE,

**By the speech of the World Bektashi Grandfather,
His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj**



This day, 15 October 2018, contains in itself a special symbolic meaning. 110 years ago, the wooden doors of this tekke, so much beloved doors for thousands of believers, not only from Tepelena, but also from Mallakastër, Gjirokastra, Vlora e Përmeti, were opened for the pupils of the first Albanian school in this region. Those pupils, of that century, so

troubled for the Albanians, in the same time with the knowledges about God, would learn the knowledges about the history, geography and especially about the beloved Albanian language, so much and so atrociously assailed and persecuted by the Ottomans and others.

Already is confirmed by our historical sciences, as well as by European ones, the fact that dur-

ing the period of the Albanian movement for Independence, the Bektashi teqes were transformed in schools for learning the Albanian language. The books of Haxhi Bektash Veli were joined by the books of the Albanian language, in the trunks of our ancestors and they remain there, together, testifying that God and the Nation cannot be denied. This majestic device led the Bektashi thought

A HEARTH OF LOVE



and the Bektashi action in those times. It is spoken a lot about the efforts of our ancestors for a latin alphabet for the Albanian language; some of them died for such an alphabet. If we have a look to the history of these times, we easily understand that for our national patriotic movement, which collaborated with Bektashi institutions, it was very clear that the destinies of our Nation could be decided by the gun and by the pen. They were conscientious that the Albanian language and the definitive separation from the Ottomans, could be the right way to join the European family, to which we truly belong and to

which we have always belonged. Koshtani teqe has been a hearth of the Albanian patriotic movement and for this reason it was burnt two times, by the greek andartes and by the esadists, while its dervishes and babas were killed or imprisoned.

Founded in the year 1807 by Baba Sadik Horasani, Koshtani teqe followed and respected all the rules of Bektashi teqes, even not written rules. This teqe was reestablished by the contribution of the believers of the region, who wanted to practice their faith, their belief to God and to contribute also to the national cause, led by the dervish or the baba of the teqe. After Baba Sadik Horasani, who came from the famous teqe of Haxhi Bektash Veli, it was Baba Ismaili, from the quarter Ruçaj of this village, who led this teqe and after him came Baba Muharrem Allkomemaj, followed by Baba Ahmeti, from Mavrova of Vlora, whose contribution is wellknown by all of us. I avail myself of this opportunity to thank all the people of Koshtan and Tepelena, who, with their marvelous human spirit, made possible for the Bektashism to grow up and to progress day to day. Also, I thank from the bottom of my heart your brother and my brother Baba Abdyl Shehaj, who since the restart of the activity of the Bektashi institutions in the year 1990, was fully devoted to the religious activity, contributing especially in Koshtani teqe, in that of Memaliaj and actually to Zalli teqe, in Gjirokastra. Let you work always for good things, Baba Abdyl!

Meantime, I think that such aniversaries should serve to all of us, not only to remember our past, however glorious it is, but also for more hope to our future, for more love to each other, for more love to our parents, for more love to Albania. High God and Haxhi Bektash Veli like to see us just like inseparable brothers, always together.

God bless all of you!

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE

BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË

KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE

NR.128 TETOR 2018

